



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:
"Administrim Biznesi i Avancuar" me profile: "Menaxhim";
"Kontabilitet-Financë"; "E Drejtë Biznesi"**

**ofruar nga
Kolegji Universitar "TBU"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Ermira Qosja

Dr. Valbona Kapllani

Qershor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master Profesional në:"Administrim Biznesi i Avancuar" me profile: "Menaxhim";
"Kontabilitet-Financë"; "E Drejtë Biznesi"**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "TBU"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Biznesit dhe Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në: "Administrim Biznesi i Avancuar" me profile: "Menaxhim", "Kontabilitet-Financë" "E drejtë Biznesi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhri MASH Nr 386, datë. 05.08. 2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 33, datë 17.06.2016 Vendim Senati Nr. 2, datë 20.03.2019 Miratuar nga MASR me shkresë nr.3575/3 Prot, datë 07.05.2019
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 159, 160, 161; datë 23.09.2022.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr 42, datë. 12.03.2021
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë i studimeve
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	N/A
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A

16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022 11 PAE / 9 PAK; 2022-2023 7 PAE / 13 PAK; 2023-2024 12 PAE / 10 PAK; 2024-2025 10 PAE / 7 PAK;
18	Numri i studentëve: (për të tre profilet)	<u>Viti akademik 2023-2024</u> Menaxhim; 3 studentë; Kontabilitet-Financë; 4 studentë; E drejtë Biznesi; 5 studentë; <u>Viti akademik 2024-2025</u> Menaxhim; 1 student; Kontabilitet-Financë; 1 student; E drejtë Biznesi; 3 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "TBU", është një institucion jopublik i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Kolegji Universitar "TBU", është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 794, datë 6.10.2010 dhe është riorganizuar me UMAS nr. 195, datë 20.04.2023 - ka hapur Fakultet të ri "Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit; me UMAS Nr. 196, datë 20.04.2023 ka riorganizuar 2 fakultete në 1 fakultet, konkretisht Fakultetin e Administrim Biznesit dhe Fakultetin e Drejtësisë, në Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë. Aktualisht Kolegji Universitar "TBU", është i organizuar në dy Fakultete:

1. Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë;
2. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;

Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë është i përbërë nga dy departamente dhe një qendër, përkatësisht:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafaj», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

3

1. Departamenti i Biznes dhe Financë;
2. Departamenti i Drejtësisë;
3. Qendra për Kërkime dhe Studime Ekonomike dhe Juridike;

Departamenti i Biznesit dhe Financës ofron programet e studimit :

1. në ciklin e parë: Bsc në “Administrim Biznesi”;
2. në ciklin e dytë: MP në “Administrim Biznes i Avancuar me profile 120 ECTS”;
3. në ciklin e dytë: MP në “Administrim Biznesi” me profile 60 ECTS;
4. në ciklin e dytë: MsC në “Administrim Biznesi” me 120 ECTS;

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit MP në “Administrim Biznes i Avancuar” 120 ECTS me profile: “Menaxhim”; “Kontabilitet – Financë”; “E drejtë biznesi”. Programi i studimit është licencuar (hapur) me Urdhrin MASH Nr 386, datë. 05.08. 2011 dhe riorganizuar me Vendim Senati Nr. 2, datë 20.03.2019, dhe miratuar nga MASR me shkresë nr.3575/3 Prot, datë 07.05.2019.

Pranimi i studentëve që ndjekin këtë program studimi të ofruar nga departamenti përkatës pranë IAL është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i TBU dhe Rregullorja e programit të studimit.

Programi i Masterit Profesional në “Administrim Biznes i Avancuar” 120 ECTS me profile: “Menaxhim”; “Kontabilitet – Financë”; “E drejtë biznesi”, në TBU synon të formojë specialistë të aftë për të përballuar sfidat e tregut të punës në sektorin privat dhe publik. Programi ofron një bazë teorike në fushat kyçe të administrimit të biznesit, si menaxhimi strategjik, qeverisja korporative dhe vendimmarrja menaxheriale. Megjithatë, për të rritur përputhshmërinë me kërkesat dinamike të tregut, rekomandohet integrimi i moduleve mbi sipërmarrjen, transformimin digjital dhe AI. Gjithashtu, pas akreditimit periodik do të duhet të punohet për të diferencuar programet master midis tyre, pra MP 60 ECTS nga 120 ECTS dhe nga Msc. Në programet MP përmirësimet do të duhet të fokusohen më tepër në krijimin e aftësive që tregu i punës kërkon lokalisht dhe globalisht, duke kontribuar kështu për një program më tërheqës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: **Prof. Dr. Ermira Qosja** dhe **Dr. Valbona Kapllani**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Profesional “Administrim Biznesi i Avancuar” 120 ECTS me profile: Menaxhim; Kontabilitet – Financë; E drejtë biznesi, i ofruar nga Departamenti i Biznesit dhe Financës të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë pranë TBU filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe të dokumenteve përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në TBU, u realizua në datën 17 dhe 18 Prill 2025, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në TBU Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësin e Departamentit të Biznesit dhe Financës dhe Dekanin e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, si dhe me Sekretarinë mësimore. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit MPABA, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.

Kolegji Universitar “TBU”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 29.05.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 139/6. Prot, datë 29.05.2025. Kolegji Universitar “TBU”, njofton në ASCAL më datë 13.06.2025 nëpërmjet shkresës me nr. 71/1 prot, datë 11.06.2025, “*Mbi shqyrtimin e draft raporteve të vlerësimit të jashtëm për programet e studimit.....*” se nuk ka komente mbi draft raportet. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 42, datë 12.03.2021 janë:

1. Institucioni, të marrë masa që stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi të zotërojë tituj dhe grada sipas parashikimeve ligjore në fuqi;
2. Institucioni, të ulë ngarkesën mësimore të stafit akademik të këtij programi studimi, të shprehur në orë dhe numër lëndësh;
3. Institucioni, në planin mësimor të këtij programi studimi, të balancojë orët në auditor dhe orët individuale për studentët e këtij programi studimi, sipas kërkesave ligjore në fuqi;
4. Institucioni, të realizojë një studim mbi tregut e punës, duke u mbështetur në kërkesat dhe pritshmëritë e bizneseve apo në opinionin e studentëve të diplomuar;
5. Institucioni, të përmirësojë shpërndarjen e krediteve midis semestrave dhe viteve akademike, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi;
6. Institucioni, të kryejë vlerësimin e vazhdueshëm të studentit si edhe vlerësimi final të lëndës, në përputhje me parashikimet e rregullores së institucionit, rregullores së programit të studimit dhe përcaktimeve ligjore në fuqi;
7. Institucioni, të marrë masa për implementimin e një sistemi informacioni të integruar, për komunikimin dhe menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe stafit akademik të këtij programi studimi.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Për rekomandimin e parë, GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur kryesisht**. Sikurse raportohet në RVB dhe në dokumentacion shoqërues, por edhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin pranë këtij programi studimi të një personeli akademik cilësor dhe me kualifikime sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Por gjithashtu, u konstatua që gjatë viteve akademike 2021-2024 pranë këtij programi studimi janë angazhuar akoma edhe pedagogë me kualifikimin master shkencor.
2. Për rekomandimin e dytë, GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion pas vizitës në institucion, GVJ konstaton se ngarkesa mësimore e personelit akademik (numër lëndësh dhe orë totale) është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe kuadrin rregullator të TBU.
3. Për rekomandimin e tretë, GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB dhe dokumentacionin shtesë të vënë në

dispozicion pas vizitës në institucion, GVJ konstaton se plani mësimor i rishikuar i këtij programi studimi rezulton me orë mësimore të balancuara mes punës individuale të studentit dhe angazhimit në leksione/seminare në auditor.

4. Për rekomandimin e katërt, GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur kryesisht**. Sikurse raportohet në RVB dhe në dokumentacion shoqërues, institucioni ka realizuar një studim të përgjithshëm të tregut në tavolinë (desk review) por jo një studim specifik për këtë program studimi mbi nevojat konkrete të tregut për aftësi dhe specializim në nivelin master professional sipas profileve. Gjatë vizitës në TBU, GVJ sugjeroi që të bëhet një fokus grup me Drejtorët e BNP të Grupit Balfin (përkatësia me grupin është një përfitim me vlerë i TBU) dhe më pas një pyetësor me punonjës që synojnë përditësimin dhe thellimin e aftësive. Mbi këtë bazë të përcaktohen aftësitë që tregu kërkon – kjo qasje i përshtatet më së miri studimeve në MP.
5. Për rekomandimin e pestë, GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion pas vizitës në institucion, GVJ konstaton se plani mësimor i rishikuar i këtij programi studimi rezulton me një shpërndarje proporcionale të krediteve mes dy semestrave (Vendim Nr.2 i Senatit Akademik datë 20.03.2024).
6. Për rekomandimin e gjashtë, GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Sikurse raportohet në RVB dhe në dokumentacion shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se syllabuset e këtij programi studimi parashikojnë dhe personeli akademik realizon vlerësimin dhe kontrollin e dijeve të studentëve gjatë gjithë semestrit përmes vlerësimit të pjesëmarrjes/diskutimit në seminare, të detyrave/projekteve të kursit, të provimit/testeve të ndërmjetme dhe të provimit final.
7. Për rekomandimin e shtatë, GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur kryesisht**. Aktualisht institucioni ishte në një fazë tranzicioni organizativ, ka implementuar një pjesë të rëndësishme të sistemit LMS TBU, SharePoint etj, dhe është në proces të implementimit të platformës Pitagora, sistemit të bibliotekës dhe përditësimin të faqes zyrtare në internet të TBU.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Administrim Biznes i Avancuar” 120 ECTS me profile: Menaxhim; Kontabilitet – Financë; E drejtë Biznesi

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Kolegji Universitar “TBU”, përgatit profesionistë me një fokus të veçantë në fushat e administrim biznesit dhe teknologjisë se informacionit, gjë që theksohet qartë në Strategjinë e IAL për vitin 2024-2029. Programet e studimit të TBU janë të lidhura me ofrimin e një edukimi cilësor nëpërmjet krijimit të kushteve dhe mundësive për zhvillimin dhe aplikimin e njohurive të marra në mënyrë profesionale, e duke synuar përshtatjen me nevojat e tregut të punës, lokal dhe ndërkombëtar.</p> <p>Në Statutin e TBU <i>Neni 8</i>, përcaktohet mjaft qartë synimi i TBU për edukim cilësor që kombinon teorinë me aftësimin praktik, me përparësi të veçantë në administrim biznes.</p> <p>Në Strategjinë Institucionale të Zhvillimit 2024-2029 theksohet që sinergia me Grupin Balfin do të kontribuojë në përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm nëpërmjet mësimdhënies, të nxënit dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe influencës në komunitet, duke siguruar njohuritë, aftësitë, moralin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen, ndërkombëtar.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</i> <i>Statuti TBU.pdf;</i> <i>3.1. TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.pdf;</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Programi Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar me porofille, zanafillën e tij e ka nga MPAB me 90 ECTS, që pas ndërhyrjeve ligjore që derivuan nga Ligji i Arsimit të Lartë

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>80/2015 u riorganizua me Vendim të Senatit Nr. 2, datë 20.03.2019 në MPAB – 60 ECTS dhe MPABA – 120 ECTS.</p> <p>Ky program, pas ristrukturimit është akredituar me VBA Nr 42; dt. 12.03.2021. Programi ka adresuar dhe adreson nevojat e tregut në funksion të plotë me prioritetet kombëtare strategjike si ato të parashtruara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030 (https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/538) si dhe perspektivat e zhvillimit të Grupit Balfin.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 2. Statuti TBU.pdf; 3.1.TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf;</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Në takimin me drejtuesin aktual dhe atë të mëparshëm të departamentit të biznesit dhe financës si dhe me stafin akademik, GVJ bëri një diskutim mbi përmbajtjen e programit MPABA, ngjashmëritë me MPAB 60 kredite dhe Msc AB.</p> <p><i>Pas këtij procesi akreditimi, GVJ sugjeron që departamenti të vlerësojë ofertën e tij akademike nisur nga qasja aktuale e TBU, ndryshimet dinamike në tregun e punës. E thënë më qartë, Departamenti do të duhet të definojë profilin e studentëve që ndjekin MP ABA – 120 ECTS, profilin e studentit të MsC dhe të atij MP AB 60 ECTS dhe mbi këtë bazë të marrë vendime për ofertën e tij akademike.</i></p> <p>GVJ vlerëson avantazhet që programet MP dhe departamenti mund të ofrojnë në tregun e arsimit të lartë, nëse targeton segmentin e duhur dhe mbi këtë bazë harton strategjinë e tij.</p> <p><i>Struktura e programit të studimit MPABA ka reflektuar pjesërisht VKM 41/2018 gjatë riorganizimit nga MP 90 kredite në 120 kredite. Vetëm në vitin e fundit (2024-2025), drejtuesit e rinj të Fakultetit e kanë formatuar në respekt të VKM 41/2018, reflektuar veçanërisht në stabilizimin e lëndëve të kategorisë B – Lëndëve karakterizuese.</i></p> <p><i>Referenca:</i> 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MP-ABA120.pdf;</p>

	<p>9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</p> <p>16. Kurrikula e programit MP Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf;</p> <p>16.5. Shkresa TBU, nr.55.dt.10.5.24 _Dergohet ne MAS Vendimi senatit &planet 24-25 (per ndryshim brenda 20%).pdf;</p> <p>16.6. Shkresa e MAS Konfirmimi i ndryshimeve ne planin e lendeve te programeve MP60&MP120 24-25.pdf;</p> <p>Info shtese 16.2. Plani mësimor i programit të studimit MP „ Administrim Biznesi“ 120 (shqip);</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të RVB, Planit Mësimor, Silabuseve të lëndëve, evidentohet që programi MPABA është hartuar duke marrë në konsideratë formimin e specialistëve me aftësi menaxheriale, për të punuar në SME dhe ndërmarrjet e mëdha shqiptare, por dhe për të qenë të përgatitur për një treg më global. Gjatë takimit me stafin akademik të Departamentit të Biznesit dhe Finances, u diskutua sesi ata përcjellin njohuritë që vijnë përmes teksteve të huaja dhe realitetit shqiptar përmes rasteve studimore, projekteve, të ftuarve në auditor dhe vizitave në biznese.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</p> <p>4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MP-ABA120.pdf;</p> <p>16. Kurrikula e programit MP Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf;</p> <p>22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf;</p> <p>Info shtese 16.2. Plani mësimor i programit të studimit MP Administrim Biznesi“ 120 (shqip);</p> <p>vizita në institucion;</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master Profesion në Administrim Biznesi i Avancuar me 3 profile në proces është përmirësuar dhe organizuar në vitin e fundit në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore.</i></p> <p><i>Dokumentat strategjike të institucionit, fakultetit dhe njësisë bazë qe e ofron kete program studimi jane në të njëjtin qëllim, atë të mbështetjes së dijes që percillet tek studentët përmes realizimit dhe përmbushjes së objektivave përkatëse.</i></p> <p><u>Sugjerohet një përshtatje e Statutit të TBU me Strategjinë e re të zhvillimit 2024-2029 në disa elementë.</u></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>TBU ka tashmë një përvojë rreth 14 vjeçare në tregun e arsimit të lartë, duke u përballur me sfida të sistemit dhe me dinamika të brendshme. Ndryshimet e fundit në strukturën e pronësisë dhe një sërë ndërhyrjesh të bëra në lidhje me strukturën e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë, me stafin drejtues të Fakultetit, punësimet në nivel Kolegji dhe Departamenti të Biznesit dhe Financës tregojnë që vendimarrja është në drejtimin e duhur.</p> <p>GVJ vlerëson bazuar dhe në takimet e zhvilluara në institucion se ndërhyrjet e bëra japin siguri për drejtimin akademik, për shkak të përvojës, background-it dhe këmbënguljes që drejtuesit kanë. Ndryshimet e propozuara në kurrikul, në planin mësimor, përmirësimet e silabuseve dhe mbi të gjitha koncepti i qartë i drejtuesve në menaxhimin e një Fakulteti Biznesi, janë garancia dhe për hapat e zhvillimit që TBU ka ndërmarrë.</p> <p><i>Referenca:</i> 2.1.4. <i>Vendim SA Nr. 51 dt. 11.09.23 mbi ristrukturimin në zbatim të urdherave 195, 196 MAS...pdf;</i> 3.1. <i>TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.pdf;</i> 3.2. <i>Strategjia e kerkimit shkencor TBU 24-29.pdf;</i> 4. <i>Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MP-ABA120.pdf; vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të</p>	<p>Programi MPABA është në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e TBU, që përcaktojnë Departamentin e Biznesit dhe Financës si njësi bazë të njësisë kryesore të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë</p> <p>Struktura e programit është në përputhje të plotë me Statutin e TBU dhe organizimi i studimeve bëhet bazuar në disa nene të Rregullores së Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë</p>

<p>programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p><i>Referenca:</i> 2. Statuti TBU.pdf; 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise.pdf; 16. Kurrikula e programit MP Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf;</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Bazuar në “Strukturën e programeve të Fakultetit për të dyja ciklet e studimit”, programi MPABA me tre profile përputhet plotësisht me fushën akademike dhe të kërkimit të Departamentit të të Biznesit dhe Financës. Qëllimi i formimit në këtë program studimi ka të bëjë jo vetëm me zhvillimin e ekonomisë lokale dhe kombëtare, por vlerësojmë që synon të përgatisë studentët për një botë globale. Pedagogët gjatë takimit u shprehën se si përmes programit, gërshetimit të lokales dhe globales, përqipen të krijojnë një strukturë programi që përgatit studentët me aftësi menaxheriale që koha kërkon.</p> <p><i>Referenca:</i> 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise.pdf; 16. Kurrikula e programit MP Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & english).pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>TBU në filozofinë e saj të zhvillimit vendos në qendër bashkëpunimin me tregun e punës dhe aftësimin e studentëve për t’iu përshtatur kërkesave në rritje për menaxhim profesional në organizatat e biznesit. Marrëveshjet institucionale të nënshkruara, por dhe bashkëveprimi me kompanitë e Grupit Balfin ka krijuar hapësira të reja për studentët dhe kanë pasuar ofertën akademike të IAL-së.</p> <p>Nga një vëzhgim në rrjetet sociale të TBU evidentohet qartë se si Fakulteti BD dhe Departamenti BF në bashkëpunim me Zyrën për Çështjet Studentore organizojnë një numër të</p>




	<p>konsiderueshëm aktivitetesh trajnuese dhe zhvilluese për studentët me kah aftësimin e tyre për tregun e punës.</p> <p><i>Referenca:</i> 37.1. <i>Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka ma.pdf;</i> 37.3. <i>Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MPABA120).pdf;</i> 38.1.2. <i>Të dhëna për trajnimet profesionale për studentët.pdf;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>TBU ka kapacitete infrastrukturore për të realizuar aktivitetet edukative dhe kërkimore shkencore. TBU ka ambiente të mjaftueshme për zhvillimin e proceseve mësimore, kërkimore, laboratorike, etj;</i></p> <p><i>Programi i studimit MPABA është në përputhje të plotë me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>TBU ka ngritur një strukturë organizative që siguron marrëdhënie frytshme bashkëpunimi midis njësive përbërëse. Struktura organizative lejon që të bëhet një ndarje e qartë e detyrave dhe e përgjegjësiwe për çdo fakultet dhe departament. Kjo bën të mundur që çdo program të plotësojë objektivat dhe të ruajë cilësinë për të cilën është krijuar.</p> <p>Drejtuesi i departamentit mbikëqyr veprimtarinë dhe zhvillimin e departamentit duke u bazuar në planin strategjik të njësive kryesore. Ai zhvillon dhe menaxhon instrumentet e konsultimit, vendim-marrjes dhe komunikimit me stafin e njësive dhe siguron që detyrat akademike dhe administrative të departamentit të</p>

	<p>shpërndahen në mënyrë të drejtë për të mundësuar zhvillimin e njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve</p> <p>Autoriteti menaxhues i Fakultetit është Dekani, i cili mbikëqyr koordinimin e aktiviteteve dhe programeve akademike të njësive bazë duke vlerësuar dhe rishikuar kurrikulën e Fakultetit, në përputhje me nevojat e tregut dhe standardet e programeve të akredituara. Dekani, duke u mbështetur mbi propozimet akademike të njësive bazë për të siguruar edhe financim të jashtëm për projekte të veçanta paraqet nevojat buxhetore të Fakultetit. Në TBU, departamentet bëjnë propozime në fillim ose në fund të vitit akademik në drejtim të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe çështjeve të tjera që lidhen me departamentin dhe i përcjell ato tek Dekani i Fakultetit i cili më pas ia paraqet propozimet Rektoratit.</p> <p><i>Referenca:</i> 2. Statuti TBU.pdf; 2.2. Struktura Organizative TBU.pdf; 5.Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf; 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë.pdf; 7. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD).pdf;</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>TBU ka një proaktivitet të lartë në bashkëpunimet me tregun e punës, të cilat i shërbejnë studentëve dhe stafit akademik. Gjithashtu, në nivel kombëtar ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me IAL-të publike dhe jopublike.</p> <p><u>GVJ vlerëson që duhet punuar më shumë në drejtim të ndërkombëtarizimit, kuptuar ky proces nga shkëmbimet Erasmus të studentëve, stafit akademik dhe administrativ, vijuar më tej me projektet europiane dhe programet "double" apo "joint".</u></p> <p><u>Gjithashtu, GVJ vlerëson që bazuar në filozofinë që TBU synon të ndjekë, shumë e rëndësishme do të ishte pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve të masterit në projektet konkrete të zhvillimit të Grupit Balfin dhe këtu të orientohen dhe diplomat.</u></p> <p><i>Referenca:</i> 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka ma.pdf; 37.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MPABA120).pdf; 47.3. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve.pdf;</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit,</p>	<p>Në lidhje me praktikat mësimore për programin e studimit MPABA 120 ECTS, institucioni aplikon marrëveshjet e</p>

<p>institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>nënshkruara, për tipologjinë e programit nuk nevojiten marrëveshje specifike.</p> <p><u>Sugjerohet që institucioni të nënshkruajë marrëveshje specifike vetëm për praktikën mësimore për këtë program studimi dhe ajo të konceptohet dhe realizohet në përputhje me synimet që drejtuesit e IAL duhet të kenë në lidhje me profilin e studentit që ndjek studimet në MP 120 kredite.</u></p> <p><i>Gjithashtu, bazuar dhe në diskutimet me stafin e Departamentit përgjegjës për këtë program studimi interes do të kishte dhe angazhimi i tyre në projekte specifike kërkimi dhe zhvillimi të Grupit Balfin.</i></p> <p><i>Referenca:</i> 37.1. <i>Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka ma.pdf;</i> 37.3. <i>Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MPABA120).pdf;</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në funksion të analizës së veprimtarisë së departamentit analizohet edhe përmbushja e objektivave të programit si dhe në lidhje me përfitimet që rrjedhin gjatë trajnimeve profesionale dhe nga marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projekteve ndërkombëtare dhe kombëtare. Në raport përfshihet analiza e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe veçanërisht pjesëmarrja e stafit akademik në programet e shkëmbimit dhe trajnimet në metodat e mësimdhënies.</p> <p><i>Në lidhje me raportin e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit do të sugjerohet përdorimin e disa indikatorëve që do e bënin të matshëm këtë komponent shumë të rëndësishëm të veprimtarisë së kolegjit universitar.</i></p> <p><i>Referenca:</i> 37.4. <i>Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf;</i> 41. <i>Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MP120.pdf;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson shumë pozitivisht proaktivitetin e TBU në lidhje me ngritjen e marrëdhënive të bashkëpunimit me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas, ndërkohë që <u>sugjeron matjen e impaktit.</u></i></p> <p><i><u>Sugjerohet githashtu rritja e angazhimit në funksion të ndërkombëtarizimit.</u></i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi MP në Administrim Biznes i Avancuar është hapur me Urdhër MASH Nr 386 dt. 05.08. 2011, ndërsa riorganizimi i tij është bërë me Vendim Senati Nr. 2, datë 20.03.2019 dhe miratuar nga MASR me shkresë nr.3575/3 Prot, datë 07.05.2019, si dhe ka marrë akreditimin e parë me VBA Nr 42, të datës 12.03.2021.</p> <p>Qëllimi i programit MPABA është të formojë dhe aftësojë menaxherë të lartë për tregun e punës dhe t'u krijojë atyre avantazh konkurrues në të. Mbështetur në të gjithë dokumentacionin e paraqitur, MPABA karakterizohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 vite akademike/4 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60 (referimi viti akademik 2024-2025); - ngarkesa mësimore 916 orë në auditor; 2034 orë jashtë tij; - forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi; <p>Programi është strukturuar në vitin akademik 2024-2025 si më poshtë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A – lëndë të formimit të përgjithshëm; 1 lëndë, 6 ECTS, 5 % e krediteve (standardi 5%-10%); - Kategoria B – lëndë të formimit karakterizues: 8 lëndë, 48 ECTS, 40 % e krediteve (standardi 30%- 40%); - Kategoria C - lëndë ndërsiplinore 6 lëndë, 36 ECTS, 30 % e krediteve (standardi 20%- 30%); - Kategoria D – lëndë të formimit plotësues: Praktika dhe Raporti i Përvojës Personale 12 ECTS, 10% e krediteve (standardi 10%); - Kategoria E – detyrime përmbyllëse: Diploma/Provim i Përgjithshëm 18 ECTS, 15% e krediteve (standardi 10%- 20%); <p><u>Gjatë shqyrtimit të programit MPABA, për vitet e tjera (3 vitet para vitit aktual) evidentohet qartë mospërputhja me VKM 41/2018 dhe për më tepër që kategoria e lëndëve karakterizuese ishte me përzgjedhje nga viti në vit.</u></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ evidenton se silabuset e lëndëve janë formuluar pjesërisht në përputhje me udhëzimet dhe dispozitat ligjore, gjithashtu nevojitet të përmirësohet përmbajtja e temave, <u>GVJ rekomandon të detajohet literatura e çdo teme dhe të jetë literaturë e 5 viteve të fundit, të rishikohet forma e vlerësimit duke iu përshtatur qëllimit të MP duke integruar më shumë elementë praktikë në kontrollin e vazhduar të njohurive.</u></p> <p><i>Referenca:</i> 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; 16. Kurrikula e programit MP Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; 16.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MP Administrim Biznesi i Avancuar" 120.pdf; Info shtese 16.2. Plani mësimor i programit të studimit MP Administrim Biznesi" 120 (shqip);</p>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e	Programi MPABA synon të formojë dhe aftësojë studentët në një spektër relativisht të gjerë të kompetencave menaxheriale dhe t'u krijojë avantazh konkurrues në tregun e punës, lokal dhe kombëtar.

<p>specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ diskutoi me Përgjegjësën dhe stafin e departamentit në lidhje me përmbajtjen e lëndëve të programit dhe të një hendeku që ekziston midis kërkesës dhe ofertës për këtë lloj masteri.</p> <p><i>Vlen të ritheksohet nevoja për të diferencuar këtë program studimi nga MP AB 60 kredite dhe Masteri i Shkencave. Më shumë se një lloj rezistence ndaj ndryshimeve në përmbajtjen e programit evidentuam një paqartësi që vjen dhe për shkak të inercisë së këtij programi. <u>Fakt është që lëndët zhvillohen së bashku, nisur dhe nga numri i kufizuar i studentëve.</u></i></p> <p><i>Nisur nga veçoria që ka TBU si pjesë e Grupit Balfin, GVJ sugjeroi realizimin e një studimi tregu bazuar në nevojat që <u>Grupi ka për të avancuar në karriere menaxherët e saj dhe për të përgatitur menaxherët e lartë.</u> GVJ vlerëson që drejtuesit e BNJ të kompanive të Grupit mund të japin një kontribut të vyer në këtë drejtim.</i></p> <p><i>Spektri i formimit është relativisht i gjerë (silabuset) dhe kjo shërben në kushtet e një tregu të vogël si Shqipëria, por në transformimet e reja dhe shumë dinamike që po pëson menaxhimi dhe tregu i punës sot, kërkohet më shumë specializim në drejtime të veçanta. Programi nën këndvështrimin edhe të ekspertëve të jashtëm mund të kishte prezencë të më shumë elementëve sipërmarrje, inovacion, digjitalizim dhe marketing.</i></p> <p><i>Referenca:</i> 16. Kurrikula e programit MP Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit MPAB120 (shqip & anglisht).pdf;</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi MPABA – 120 ECTS me tre profile: Menaxhim; KONTabilitet - Financë dhe E drejtë biznesi, strukturohet si më poshtë:</p> <p><i>Kategoria A – lëndë të formimit të përgjithshëm; 1 lëndë,</i></p> <p style="padding-left: 40px;"><i>Lidershipi në Organizatë – 6 ECTS;</i></p> <p><i>Kategoria B – lëndë të formimit karakterizues: 8 lëndë, 48 ECTS</i></p>
	<p style="padding-left: 40px;">Auditim i Avancuar</p> <p style="padding-left: 40px;">Drejtim financiar i avancuar</p> <p style="padding-left: 40px;">Menaxhim Projektsh</p>




	<p>Menaxhim Strategjik</p> <p>Qeverisje e Korporatave</p> <p>Taksim i Biznesit</p> <p>Marrja e Vendimeve Menaxheriale</p> <p>Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit e Avancuar</p> <p><i>Kategoria C - lëndë ndërdisiplinore 6 lëndë, 36 ECTS. Në këtë kategori kryesisht çdo profil ka lëndët e veta, sigurisht ka dhe lëndë të përbashkëta, kryesisht janë dy lëndë që janë në çdo profil.</i></p> <p><i>Kategoria D – lëndë të formimit plotësues: Praktika dhe Raporti i Përvojës Personale 12 ECTS, 10% e krediteve (standardi 10%) ;</i></p> <p><i>Kategoria E – detyrime përmbyllëse: Diploma/Provimi i Përgjithshëm 18 ECTS.</i></p> <p><i>Ndonëse në kategorinë e detyrimeve përmbyllëse ka alternativë mes Diplomës dhe Provimit, duket që në masë studentët zgjedhin provimin, madje dhe në rastet kur kishin mesataren e duhur.</i></p> <p><i><u>Departamenti duhet të bëjë përpjekje për integrimin e projekteve reale në punimin e diplomës, kjo do t'u japë mundësi studentëve të sfidohen, por do t'i jepte dhe një dimension tjetër studimit në MPABA</u></i></p> <p><i>Referenca:</i> <i>16. Kurrikula e programit MP Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf;</i> <i>37. Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse).pdf;</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të</p>	<p>N/A</p>

studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N/A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N/A
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	<p>Gjatë vizitës në institucion në lidhje me ngjashmërinë e Programit MPABA, GVJ kërkoi nga drejtuesi i departamentit në mënyrë të përsëritur të identifikonte ngjashmërinë me programe dhe shkolla të tjera.</p> <p><i>Duket që nga njëra anë për shkak të inercisë së programit nga 90 ECTS në 120 ECTS si dhe të përshtatjeve që ka pësuar për t’u përputhur me VKM 41/2018 nga ana tjetër, shtuar përjasjen zhvilluese të drejtimit të TBU në dy vitet e fundit, pas akreditimit në process, IAL do të duhet të definojë plotësisht ngjashmërinë e programit me shkolla të tjera.</i></p>




<p>Kriteri 8.Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, program i studimit MPABA i përket nivelit 7.</p> <p>Programi MPABA – ka kodet e tij dhe çdo lëndë ka gjithashtu kodet e saj. Në të gjithë këtë proces, TBU është bazuar në VKM 310/2022.</p> <p><i>Referenca:</i> 65.3. Korrespondenca me MAS mbi kodifikimin e programeve të studimit.pdf; 654SHK~1.PDF;</p>			
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>N/A</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se në lidhje me standardin “Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore” vetëm në vitin e fundit strukturimi i programit është kryesisht në përputhje.</i></p> <p><i>Pas këtij procesi akreditimi do të duhet të bëhet përshtatja e mëtejshme e programit me dinamikën e tregut dhe profilin e studentit që synohet në këtë program; si dhe sistemimi i plotë i silabuseve në përputhje me kërkesat e ligjit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.2</p>	
<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse</p>	<p>TBU është akredituar me Vendimin Nr. 56, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit. Me UMAS Nr. 196, date 20.04.2023, TBU</p>

<p>për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>ka riorganizuar dy fakultete në një fakultet, konkretisht Fakultetin e Administrim Biznesit dhe Fakultetin e Drejtësisë, në Fakultetin e Biznesit dhe Drejtësisë. Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë është i përbërë nga dy departamente dhe një qendër, përkatësisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Biznesit dhe Financës; 2. Departamenti i Drejtësisë; 3. Qendra për Kërkime dhe Studime Ekonomike dhe Juridike; <p>Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë ofron programe studimi në dy cikle: Bachelor dhe Master. Departamenti i Biznesit dhe Financës mbulon 4 programe studimi:</p> <p>në ciklin e parë: Bsc në “Administrim Biznesi” në ciklin e dytë: MP në “Administrim Biznesi i Avancuar me 120 ECTS; në ciklin e dytë: MP në “Administrim Biznesi” me 60 ECTS në ciklin e dytë: MSc në “Administrim Biznesi” me 120 ECTS</p> <p>TBU për shkak të numrit të studentëve nën 600 ka nënshkruar një Marrëveshje me MAS në lidhje me përcaktimin e personelit akademik.</p> <p><i>Referenca:</i> 2. Statuti TBU.pdf; 2.2. Struktura Organizative TBU.pdf; 5.Rregullore e Kolegjit Universitar “TBU”.pdf; 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë.pdf; 7 Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD).pdf; 75. Marrëveshja e MAS TBU dt.9.07.2024 Përcaktimi i Personeli Akademik.pdf; MP120 Tabelat 1,2,4,6&12viti 24-25.pdf;</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë ka në përbërje të tij aktualisht dy departamente dhe qendren. Mbështetur në nenin 25 të “Ligjit të arsimit të lartë, Departamenti ka në përbërje të tij të paktën 7 (shtatë) anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Në përputhje me këtë TBU ka nënshkruar një marrëveshje me Ministrinë e Arsimit (datë 09.07.2024) për të ndryshuar numrin minimal të anëtarëve të departamentit nga 7 në 5, kjo për shkak të numrit të ulët të studentëve që është më pak se 600 studentë në tre vitet e fundit.</p> <p>Referuar dok të marrë pas vizitës për vitin akademik 2024-2025 Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë përfshin në strukturën e tij 35 anëtarë si personel akademik nga të cilët 16 anëtarë janë personel</p>

akademik efektiv (PAE) dhe 19 anëtarë janë personel akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë	
	PAE	PAK
Prof.Dr	2	-
Prof.Asoc	1	2
Dr/PhD	6	5
Magjistër		3
Msc	7	9
Gjithsej	16	19

Bazuar në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni Departamenti i Biznesit dhe Financës për tre vite akademike përbëhet nga si më poshtë vijon:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	-	3	-	2	-
Prof. Asoc.	1	1	1	2	1	2
Dr./PhD.	1	1	2	10	3	5
Msc	1	11	1	11	-	8
Totali	4	13	7	23	6	15

Qartë në tabelë duket që ngarkesa është mbajtur kryesisht nga PAK. Departamenti i Biznesit dhe Financës nuk ka të angazhuar personel ndihmës akademik.

Referenca:

27. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësine kryesore dhe njësine përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2).pdf;

28. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit MPABI20 (Aneks Tabela 6,12,7 & 8).pdf;

75. Mareveshja e MAS TBU dt.9.07.2024 - Përcaktimi i Personeli Akademik;

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton

Në Vendimin 32 të dt. 9.10.2024 të Rektores së TBU, janë përcaktuar koordinatorët e programeve të Departamentit të Biznesit dhe Financës. Detyrat e koordinatorit të programit janë të

një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>përcaktuara në Rregulloren e Departamentit të Biznesit dhe Financës dhe në Rregulloren e Programit të Studimit MPABA.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>7. <i>Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD).pdf;</i></p> <p>9. <i>Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</i></p> <p>39. <i>Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit MP120.pdf;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Njësia kryesore / bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike.</i></p> <p><i>Departamenti i Biznesit dhe Financës ka përzgjedhur kordinatorin e programit të studimit. Koordinatorin e Programit të studimit ka rol kyç në sigurimin e cilësisë së programit të studimit dhe siguron garantimin e suksesit të studentëve.</i></p> <p><i>Departamenti dhe IAL duhet të konsiderojnë përmirësimin e raportit të PAE/PAK në funksion të PAE.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Programi MP në Administrim Biznesi i Avancuar 120 ECTS synon të formojë dhe aftësojë menaxherë të lartë për tregun e punës dhe t'u krijojë atyre avantazh konkurrues në të.</p> <p>Programi është strukturuar në vitin akademik 2024- 2025, në përputhje të plotë me udhëzimet e MAS dhe standartet e cilësisë, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A – lëndë të formimit të përgjithshëm; 1 lëndë, 6 ECTS. 5 % e krediteve (standardi 5%-10%);

	<ul style="list-style-type: none"> - Kategoria B – lëndë të formimit karakterizues: 8 lëndë, 48 ECTS, 40 % e krediteve (standardi 30%- 40%); - Kategoria C - lëndë ndërsiplinore, 6 lëndë, 36 ECTS – 30 % e krediteve (standardi 20%- 30%); - Kategoria D – lëndë të formimit plotësues: Praktika dhe Raporti i Përvojës Personale 12 ECTS, 10% e krediteve (standardi 10%); - Kategoria E – detyrime përmbyllëse: Diploma/Provim i Përgjithshëm 18 ECTS, 15% e krediteve (standardi 10%- 20%). <p><i>GVJ vlerëson që ndonëse në akreditimin paraprak të programit nuk ka një sugjerim në lidhje me kategorizimin e lëndëve, FBD ka reflektuar dhe ka bërë për vitin 2024-2025 ndryshimet e duhura, duke sjellë në kufijtë e përputhshmërisë me ligjin kurrikulën e MPABA.</i></p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; 16. Kurrikula e programit MP „ Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf; Info shtese 16.2. Plani mësimor i programit të studimit MP „ Administrim Biznesi“ 120 (shqip)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi MPABA 120 ECTS i ofruar nga Departamenti Biznesit dhe Financës, bazuar në planin mësimor të vitit akademik 2024-2025 karakterizohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 vite akademike/4 semestra; - semestri ka 15 javë; - kredite për semester 30 / për vit akademik 60 (kjo situatë i referohet vetëm vitit të fundit akademik, 2024-2025, për 3 vitet e tjera kreditet në semestër janë të pabalancuara); - ngarkesa mësimore 916 orë në auditor; 2034 orë jashtë tij; - orët në auditor ndahen si më poshtë: <p style="padding-left: 40px;">Viti I – Semestri 1 – 300 orë; Semestri 2 – 248 orë;</p> <p style="padding-left: 40px;">Viti II – Semestri 1- 300 orë; Semestri 2 – 68 orë</p> <p>-forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi.</p>

	<p>Bazuar në Planin Mësimor të vitit 2024-2025, rezulton se lëndët janë strukturuar me 4 orë në javë, 2 orë leksion dhe 2 orë seminar, pra orët total në auditor janë 60 dhe orët për punën individuale janë 90, për çdo lëndë.</p> <p>Përsa i përket Praktikës, ajo është konceptuar me 16 orë në auditor, 8 orë zhvillohen në Semestrin 2 të vitit I dhe 8 orë në Semestrin e dytë të vitit të II-të, pjesa tjetër është praktikë nëpër organizata.</p> <p>Përsa i përket detyrimeve përmbyllëse – Provim i Përgjihshëm apo Punim Diplome, nga Plani Mësimor duket është konceptuar si punë individuale (450 orë).</p> <p><i>Referenca:</i> 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; 16. Kurrikula e programit MP Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf; 16.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MP „Adminstrim Biznesi i Avancuar“ 120.pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; 37.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FBD.pdf; Info shtese 16.2. Plani mësimor i programit të studimit MP Administrim Biznesi“ 120 (shqip);</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informimi i studentëve në lidhje me kriteret specifike dhe të përgjithshme të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit bëhet përmes një tërësie dokumentacioni që përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloren e TBU; - Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë; - Rregulloren e Departamentit; <p>Drejtuksi i Departamentit u shpreh që është në komunikim të vijueshëm me studentët në lidhje me shumë elementë të mbarëvajtjes së tyre akademike.</p> <p><i>Referenca:</i> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf; 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë.pdf; 7. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD).pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban</p>	<p>Programi i studimit në MPABA synon të krijojë një formim dhe aftësim në fushat:</p>

<p>informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -Lidership; -Drejtimit Financiar dhe Auditim; -Menaxhim i sistemeve të informacionit; -Vendimmarrje; -Qeverisje korporatash dhe Menaxhim Strategjik; -Taksim Biznesi; <p>Programi MPABA është konceptuar me 3 profile:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhim; - Financë - E drejtë biznesi; <p>Profilet janë konceptuar me 2 lëndë të përbashkëta dhe 4 lëndë të ndryshme (struktura e kurrikulës për vitin akademik 2024-2025)</p> <p><u>Në takimin në institucion, sugjeruam që programi ka nevojë për një lloj përditësimi duke reflektuar transformimin digjital, sipërmarrjen, inovacionin, marketingun dixhital dhe AI. Gjithashtu, për një master me 120 kredite, që synon të përgatisë menaxherë të lartë dhe që në program ka parashikuar punimin e diplomës me 18 ECTS, GVJ vlerëson nevojën për një lëndë të metodave të kërkimit.</u></p> <p><u>Nga pikëpamja e formatit të silabuseve duhet të respektohet plotësisht VKM 41 të vitit 2018. GVJ sugjeron që syllabuset të vijojnë të përmirësohen, të përditësohen dhe literatura të rifreskohet, për një pjesë të lëndëve.</u></p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</p> <p>16. Kurrikula e programit MP Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf;</p> <p>16.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MP Administrim Biznesi i Avancuar" 120.pdf;</p> <p>22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf;</p> <p>Info shtese 16.2. Plani mësimor i programit të studimit MP „ Administrim Biznesi" 120 (shqip);</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është</p>	<p>Ky program studimi është objekti i diskutimeve për përmirësimet e vazhdueshme. Kjo frymë u ndje shumë përgjatë vizitës në</p>

në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	<p>institucion dhe diskutimit me Dekanin, stafin akademik dhe koordinatoren e cilësisë së IAL-së. Në këtë diskutim janë të përfshirë mjaftueshëm edhe studentët, opinionet e të cilëve tërhiqen dhe analizohen në departament.</p> <p>Njësia kryesore përmes Dekanit ka bërë përpjekje të qenësishme në dy vitet e fundit për të përmirësuar në aspekte të ndryshme kurrikulën e këtij programi, të cilat kanë bërë të mundur përputhshmërinë e programit në vitin e fundit akademik me udhëzimet e MAS dhe standardet e cilësisë.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson që FBD dhe DBF, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet dhe dokumentat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor.</i></p> <p><i>DBF për vitin akademik 2024-2025 ka bërë të mundur organizimin e programit plotësisht në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</i></p> <p><u><i>GVJ sugjeron që programi ka nevojë për një lloj përditësimi duke reflektuar transformimin digjital, sipërmarrjen, inovacionin, marketingun dixhital.</i></u></p> <p><u><i>Gjithashtu sugjerohet që syllabuset të vijojnë të përmirësohen, të përditësohen dhe literatura të rifreskohet, për një pjesë të lëndëve.</i></u></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të	<p>Programi i studimit në MPABA synon të krijojë një formim dhe aftësim në fushat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidership; - Drejtim Financiar dhe Auditim; - Menaxhim i sistemeve të informacionit; - Vendimmarrje;

<p>mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Qeverisje korporatash dhe Menaxhim Strategjik; - Taksim Biznesi; - Programi MPABA është konceptuar me 3 profile: - Menaxhim; - Financë; - E drejtë biznesi; <p>Profilet janë konceptuar me 2 lëndë të përbashkëta dhe 4 lëndë të ndryshme (Kurrikula MPABA për vitin 2024-2025).</p> <p>Kështu, lëndët: Zhvillim Personal dhe Komunikim Ndërpersonal, E drejtë Biznesi e Avancuar zhvillohen në të tre profilet, ndërkohë 4 lëndët e tjera theksojnë formimin dhe aftësimin në funksion të profilit të zgjedhur.</p> <p>Bazuar në Planin Mësimor të vitit 2024-2025, rezulton se lëndët janë strukturuar me 4 orë në javë, 2 orë leksion dhe 2 orë seminar, pra orët total në auditor janë 60 dhe orët për punën individuale janë 90.</p> <p>Praktikës Profesionale është konceptuar me 16 orë në auditor, 8 orë zhvillohen në Semestrin 2 të vitit I- rë dhe 8 orë në Semestrin e dytë të vitit të II-të, pjesa tjetër është praktikë nëpër organizata.</p> <p>Detyrimet përmbyllëse janë konceptuar me opsionet Provim i Përgjithshëm apo Punim Diplome, në funksion të mesatares që studentët kanë në studimet MPABA, nga Plani Mësimor duket që diplomës është konceptuar si punë individuale (450 orë).</p> <p><i>Referenca:</i> 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; 16. Kurrikula e programit MP Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf; 16.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MP „Administrim Biznesi i Avancuar“ 120.pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; Info shtese 16.2. Plani mësimor i programit të studimit MP „ Administrim Biznesi“ 120 (shqip);</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe</p>	<p>Programit MPABA 120 ECTS i ofruar nga Departamenti i Biznesit dhe Financës, bazuar në planin mësimor të vitit akademik 2024-2025 karakterizohet nga:</p>
	<ul style="list-style-type: none"> - 2 vite akademike/4 semestra; - semestri ka 15 javë;

<p>rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>- kredite për semester 30/ për vit akademik 60 (kjo situatë i referohet vetëm vitit të fundit akademik, 2024-2025, për 3 vitet e tjera kreditet në semestër janë të pabalancuara)</p> <p>- ngarkesa mësimore 916 orë në auditor; 2034 orë jashtë tij;</p> <p>- orët në auditor ndahen si më poshtë:</p> <p>Viti I – Semestri 1 – 300 orë; Semestri 2 – 248 orë;</p> <p>Viti II – Semestri 1- 300 orë; Semestri 2 – 68 orë</p> <p>Bazuar në Planin Mësimor të vitit 2024-2025, rezulton se lëndët janë strukturuar me 4 orë në javë, 2 orë leksion dhe 2 orë seminar, pra orët total në auditor janë 60 dhe orët për punën individuale janë 90.</p> <p><i>Referenca:</i> 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi i Avancuar” me 120 Kredite.pdf; 16. Kurrikula e programit MP „ Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf; 16.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MP „Administrim Biznesi i Avancuar” 120.pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; Info shtese 16.2. Plani mësimor i programit të studimit MP „ Administrim Biznesi” 120 (shqip);</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Vlerësuesit në komunikim me stafin, drejtuesit e departamentit <u>sugjeruan</u> domosdoshmërinë e përmirësimit të raportit teori-praktikë, reflektimit në program të përvojave të shkollave ndërkombëtare.</p> <p><i>GVJ sugjeron të rifreskohen përmbajtjet e lëndëve, të ketë më shumë elementë inovativë, të rifreskohet literatura me literaturë të shtëpive më të mira botuese akademike si Pearson apo McGraë Hill; të pasurohen seminarët me rastet studimore bashkëkohore dhe t’i jepet një peshë më e madhe punës në projekte dhe më shumë peshë dhe në vlerësim.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që departamenti të bëjë një studim më të strukturuar në tregun lokal dhe më gjerë, të përdorë fokus grupet me studentët, me alumnit dhe tregun e punës, si dhe programe të ngjashme në rajon dhe më gjerë për të parë dinamikën e tyre.</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit</p>	<p>Programi MPABA është hartuar me lënde dhe module (gjithsej - 120 ECTS) në përputhje të plotë me sistemin evropian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve, në përputhje të plotë</p>

<p>teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe VKM Nr. 41/viti 2018, dhe si i tillë i jep mundësinë studentëve të transferojnë studimet brenda dhe jashtë Shqipërisë.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 16. Kurrikula e programit MP Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf; 16.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MP Administrim Biznesi i Avancuar“ 120.pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; Info shtese 16.2. Plani mësimor i programit të studimit MP „ Administrim Biznesi“ 120 (shqip);</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset janë në shqip dhe anglisht të dokumentuara në platformën e Ascal. Formatit i silabuseve në pjesën më të madhe është në përputhje me VKM Nr 41, të vitit 2018,</p> <p>Vlen të theksohet si element pozitiv i përmirësimit të cilësisë që TBU ka ngritur një procedurë të brendshme për monitorimin e silabuseve.</p> <p><u>Si në të gjitha IAL-të shqiptare mbetet sfida, përdorimi i literaturës nga botuesit prestigjiozë të librit akademik dhe literatura e 5 viteve të fundit, detajimi i metodave që përdoren në seminar, diversifikimi i metodave të mësimdhënies e mësimnxënies, përfshirja në silabus e të ftuarve nga biznesi në auditor, vizitat në biznese, konkurset e ndryshme.</u></p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; 40. Formatit i relacionit për monitorimin e silabuseve.pdf);</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit MPABA, synon të formojë studentët me njohuri, aftësi dhe qëndrime të domosdoshme për tregun e punës lokal dhe më gjerë. Në silabuset e lëndëve shprehen qartë objektivat dhe rezultatet që lëndët/modulet synojnë të arrijnë dhe gjithë mënyra si ngrihen tematikat javë pas javë dhe si ndërtohen seminarët/ detyrat e kursit dhe rastet studimore është në shërbim të punësimit të tyre dhe angazhimit në tregun e punës dhe për nivelin e tretë të studimeve.</p>

Ky program mbulon një shtet të gjerë të temave të rëndësishme për administrimin e biznesit dhe zhvillimin e aftësive menaxheriale. Megjithatë, disa elementë mund të forcohen për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës.

GVJ detajon si vijon :

Sfidat dhe Pikat për Përmirësim:

• **Mungesa e Lëndëve mbi Sipërmarrjen**

Tregu i punës në Shqipëri ka një nevojë në rritje për sipërmarrës dhe menaxherë të aftë që të përshtaten me teknologjitë e reja dhe tendencat e tregut.

• **Mungesa e Fokusit në Transformimin Digjital dhe AI**

Me rritjen e përdorimit të inteligjencës artificiale dhe transformimit digjital, studentët duhet të kenë njohuri mbi **Strategjitë e Transformimit Digjital** për të qenë konkurrues.

• **Specializimi në Fushat e Kërkuara nga Tregu**

Duhet të analizohen sektorët kryesorë të punësimit në rajon, si turizmi, agrobiznesi, sektori financiar dhe administrata publike, dhe të krijohen **modulet e specializuara** në këto fusha.

Rekomandime për Përmirësim:

1. **Shtimi i Lëndëve mbi Sipërmarrjen dhe Transformimin Digjital**

2. **Përmirësimi i Lidhjes me Tregun e Punës**

○ Përmes orientimit të detyrave/projekteve/diplomave dhe praktikave mësimore në çështje dhe problematika konkrete (Kjo qasje në rastin e TBU është plotësisht e mundur nëse ngrihen e bëhen funksionalee struktura në Kolegj).

○ Organizimi i forumeve të karrierës.

3. **Zgjerimi i Ofrimit të Zgjedhjeve të Kurseve për Specializim**

○ Mund të përfshihen kurse të tilla si **Menaxhimi i Bizneseve të Vogla dhe të Mesme (SME**

	<p>Management) ose Menaxhimi i Kapitali Human për studentët që dëshirojnë të specializohen.</p> <p>4. Fuqizimi i Përdorimit të Analizave dhe Softuerëve të Biznesit</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Shtimi i njohurive mbi softuerët e analizave financiare, CRM dhe ERP, të cilët janë të domosdoshëm në administrimin e biznesit modern. <p>5. Përmirësimi i Përgatitjes për Tregun Ndërkombëtar</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Zhvillimi i lëndëve në gjuhën angleze për të rritur aftësitë ndërkombëtare të studentëve dhe lehtësuar integrimin e tyre në tregun e huaj të punës. 			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Megjithatë, si është përmendur edhe më lart, duhet që programi të përditësohet sipas rekomandimeve me lëndë të cilat janë më afër nevojave të një tregu që ndryshon vazhdimisht.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin “Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës”, sa i takon kompetencave të ofruara <u>GVJ rekomandon shtimin e lëndëve mbi sipërmarrjen, kapitalin human, transformimin digjital dhe përdorimi i softuerëve bashkëkohorë të biznesit, për të rritur konkurrueshmërinë ndërkombëtare, disa lëndë mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze.</u></i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Gjatë vizitës në TBU, një nga diskutimet më të rëndësishme me drejtuesin e departamentit (aktual dhe të mëparshëm) dhe stafin akademik kishte të bënte me përmbajtjen e programit MPABA – 120 ECTS dhe se si ky program duhet të diferencohet nga programi Msc dhe MPAB – 60 ECTS.</p> <p><u>GVJ sugjeron:</u></p> <ul style="list-style-type: none">- nisur nga specifikat që TBU ka (pjesë e Grupit Balsfin), zhvillimin e një fokus grupi me drejtuesit e BNJ të Grupit në lidhje me hendekun e kompetencave që ndeshin në pozicionet menaxheriale;- Gjithashtu, nisur po nga përmasat e grupit mundet të zhvillojnë intervista dhe pyetësorë, miksimi i kësaj analize me fokus grupet e studentëve aktualë dhe alumni do të krijonte një bazë shumë të mirë vlerësimi mbi strategjitë e programeve master ne TBU;- Përvoja e shkollave që vijnë si bashkëpunim i universitetit me industrinë do të pasuronte më tej qasjen e TBU në zhvillimin e saj afatgjatë;- Në vlerësimin e GVJ, TBU do të duhet të definojë profilin e studentit që ndjek një MP – 120 ECTS nga ai i MsC dhe MPAB -60 ECTS; <p>Aktualisht, TBU ka krijuar Bordet e Tregut të Punës sipas departamenteve.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 14.1. Vendim dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD.pdf;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar,</p>	<p>Gjatë takimit me drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik, ata theksuan qasjen shumë pozitive që kanë në ndërveprimin me studentët. Plotësimi i kriterëve të standardit kërkon që krahas qasjes institucionale për të vlerësuar përmes pyetësorëve cilësinë e veprimtarisë akademike dhe administrative të universitetit në përgjithësi, duhet të ndërtohet një metodologji dhe procedurë për</p>

<p>për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p><i>të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies së çdo pedagogu të departamentit dhe të detajohet pyetësi në funksion të lëndëve dhe pedagogëve. Shumë e rëndësishme është që veprimtaritë që bëhen të dokumentohen.</i></p> <p><i>Referenca: 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; vizita në institucion;</i></p>		
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Drejtimi i ri i TBU dhe FBD në dy vitet e fundit, ka dëshmuar për një qasje zhvilluese në respekt të udhëzimeve të MAS dhe standardeve, bashkëpunimin me tregun e punës dhe kompanitë e Grupit Balfin, bashkëpunimin me shumë IAL në vend dhe hedhjen e hapave të parë drejt ndërkombëtarizimit dhe punës me projekte.</p> <p>I gjithë ky angazhim në dy vitet e fundit ka filluar të japë rezultatet e veta dhe kjo reflektohet në punësimet e kryera në nivel drejtuesish, stafi akademik dhe përmirësimi të dukshëm të procesit të menaxhimit akademik. Natyrisht që dhe për shkak të procedurave ligjore dhe proceseve në vijim të akreditimit, rezultatet do të kërkojnë kohën e tyre.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që Departamenti dhe Fakulteti kanë një qasje shumë proaktive ndaj tregut dhe partneriteteve dhe rezultatet janë të dukshme në dy vitet e fundit.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron zhvillimin e një fokus grupi me drejtuesit e BNJ të Grupit në lidhje me hendekun e kompetencave që ndeshin në pozicionet menaxheriale dhe orientimin strategjik në përvojat e shkollave që vijnë si bashkëpunim i universitetit me industrinë.</i></p> <p><i>Në vlerësimin e GVJ, TBU do të duhet të definojë profilin e studentit që ndjek një MP – 120 ECTS.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi është hartuar t'i pajisë studentët me njohuri të avancuara në tematika specifike në studimet e biznesit. Ndërsa nga një anë, programi synon të përmirësojë shprehitë praktike të zgjidhjes së problemeve të biznesit, nga ana tjetër programi synon të aftësojë studentët me njohuri të gjera e të thelluara teorike të tilla që të aftësojnë studentët në prirjen strategjike.</p> <p>Programi është në përputhje të plotë me Strategjinë e Zhvillimit të TBU për vitin 2024-2029 dhe Strategjinë e Kërkimit Shkencor për të njëjtën periudhë. Institucioni po bën të gjitha përpjekjet për të integruar të gjitha veprimtaritë e veta me synimet afatmesëm dhe afatgjata.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 3.1. TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.pdf; 3.2. Strategjia e kërkimit shkencor TBU 24-29.pdf;</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Në Rregullores e TBU përcaktohen detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore/njësive bazë në raport me administrimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe të kërkimit.</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë përmes një tërësie nenesh paraqiten dispozitat e përgjithshme, programet e studimit, elementet e programeve të studimit, elementët e kontrollit të dijës etj.</p> <p>Në Rregulloren e Departamentit të Biznesit dhe Financës, pasqyrohet mënyra si organizohet Departamenti, funksionet e tij në bashkërendimin e të gjitha veprimtarive mësimore dhe shkencore, kompetencat e drejtuesit të departamentit dhe kompetencat e koordinatorit të programit. Rregulloret në nivel Universiteti dhe Fakulteti janë në përputhje të plotë me dokumentat kryesore të MAS, veçanërisht ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2015.</p> <p><i>Referenca:</i> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf; 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë.pdf; 7. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD).pdf;</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit</p>	<p>Departamenti nxit studentët për t'u bërë pjesë e aktiviteteve të ndryshme, që nga lektorët e ftuar në auditor, vizitat në biznese,</p>

<p>dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>akademitë dhe trajnimet e zhvilluara në TBU, thirrjet për shkëmbimet Erasmus, pjesëmarrjen në konferencën e TBU organizuar për herë të parë këtë vit akademik.</p> <p>E gjithë kjo përqsje reflektohet dhe në Strategjinë e Zhvillimit të TBU dhe Strategjinë e Kërkimit Shkencor për periudhën 2024-2029. Përmes medias sociale të TBU, evidentohet më së miri përqsja proaktive në dobi të formimit dhe perspektivës në karrierë të studentëve. Një fakt pozitiv në këtë drejtim ishte dhe punësimi i disa studentëve në kohë të ndryshme më pozicione administrative dhe menaxheriale në institucion (ky fakt u evidentua gjatë vizitës në TBU dhe takimeve me grupe të ndryshme).</p> <p><i>Referenca:</i> <i>TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</i> <i>3.1. TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.pdf;</i> <i>3.2. Strategjia e kerkimit shkencor TBU 24-29.pdf;</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Kolegji universitar “TBU” po bën përpjekje për të mbështetur një sërë aktiviteteve të natyrës studimore dhe kërkimore. Kështu këtë vit akademik organizoi për herë të parë konferencën shkencore duke mbështetur financiarisht të gjithë stafin e brendshëm të institucionit.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion Drejtuesi i Qendrës për Kërkime dhe Studime ekonomike dhe Juridike diskutoi për qasjen e re në FBD në drejtim të punës kërkimore dhe me projekte. Tashmë në TBU ka nisur puna për botimin e numrit të parë të një reviste shkencore. Gjithashtu, gjatë takimit me stafin e Departamentit të Biznesit dhe Financës, ata u shprehën që këtë vit akademik, do të ketë një mbështetje financiare për pedagogët që avancojnë në tituj shkencorë, por ende nuk ishte formuluar një politikë e qartë institucionale në këtë drejtim.</p> <p><u><i>GVJ sugjeron hartimin e një politike me kriteret të qarta dhe të matshme për mbështetjen e aktivitetit kërkimor shkencor të stafit akademik.</i></u></p> <p><i>Referenca:</i> <i>01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</i> <i>vizita ne institucion;</i></p>

Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin “Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor” departamenti po bën përpjekjet e duhura në këtë drejtim duke organizuar për herë të parë një konferencë, nisur punën për botimin e një revistë shkecore.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron hartimin e një politike me kriteret të qarta dhe të matshme për mbështetjen e aktivitetit kërkimor shkencor të stafit akademik.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, departamenti është njësia përgjegjëse që mbështet grupet kërkimore shkencore dhe bashkëvepron me strukturat dhe personat përgjegjës në institucion për kërkimin shkencor. Nga pikëpamja institucionale, evidentojmë që TBU ka hartuar Strategjinë e Kërkimit Shkencor për periudhën 2024-2029.</p> <p><i>GVJ sugjeron hartimin e Strategjisë së Ndërkombëtarizimit, e domosdoshme në kushtet e reja të zhvillimeve demografike e sociale në Shqipëri dhe në përputhje dhe me Strategjinë e Qeverisë Shqiptare në lidhje me arsimin e lartë.</i></p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf 3.2. Strategjia e kërkimit shkencor TBU 24-29.pdf;</p>

<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>TBU ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Strategjinë e Kërkimit Shkencor për periudhën 2024-2029, duke vendosur një sërë objektivash ambicioze për kërkimin shkencor, për madhësinë që aktualisht kolegji ka.</p> <p>Në takimin në institucion me Dekanin e FBD dhe Drejtuesin e Qendrës për Kërkime dhe Studime Ekonomike dhe Juridike diskutuam për hapat e parë pozitivë të marrë në këtë drejtim, organizimi i një konference shkencore, nisja e punës për botimin e një reviste shkencore dhe pjesëmarrja në projektet e para europiane, ku stafi i FBD ka një rol të rëndësishëm në rritje, aplikim dhe pjesëmarrje.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 3.1. TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.pdf; 3.2. Strategjia e kërkimit shkencor TBU 24-29.pdf; 43.1.1. Indikatorët e vlerësimit të performancës kërkimore-shkencore për personelin akademik.pdf; 43.1.2. Formular i raportimit të punës kërkimore shkencore.pdf;</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Gjithashtu, vlen të theksohet një projekt aplikativ i nisur në bashkëpunim me Tirana Bank, ku angazhohen dhe staf i dy fakulteteve të TBU. TBU ka mundur të aplikojë dhe fitojë projekte dhe në AKKSHI, një hap pozitiv për forcimin e grupeve kërkimore brenda departamenteve, fakulteteve dhe universitetit, nisur nga madhësia e TBU (në numrin e stafit akademik dhe administrativ). Tashmë Qendra ka hartuar rregulloren e funksionimit të saj dhe në nivel institucional janë përcaktuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - indikatorët e vlerësimit të performancës në punën kërkimore shkencore; - formulari i raportimit të punës kërkimore shkencore. <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 3.1. TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.pdf; 3.2. Strategjia e kërkimit shkencor TBU 24-29.pdf; 43.1.1. Indikatorët e vlerësimit të performancës kërkimore-shkencore për personelin akademik.pdf; 43.1.2. Formular i raportimit të punës kërkimore shkencore.pdf;</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon</p>	<p>Ekspertët e jashtëm vlerësojnë që studimi i duhur mbi Tregun e Punës, fokus grupet me studentët që vazhdojnë studimet,</p>

<p>profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>këshillimi me aktorë të tregut të punës, gjurmimi i studentëve që diplomohen, etj, do të ishin testimi më efikas i suksesit të programit dhe i konkurrueshmërisë së tij.</p> <p>Në kushtet e një tregu të vogël, programi duhet të ketë ose një specifikë lokale të fortë ose një dinamikë dhe qasje që mund ta bënte konkurrent të fortë në tregun e arsimit të lartë. Kjo besojmë mbetet një sfidë e fortë për departamentin dhe fakultetin që ofron programin e studimit në vlerësim.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>N / A</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>N / A</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se, në lidhje me standardin "Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor", Institucioni ka bërë hapat e duhura në këtë drejtim në viitin e fundit akademik, mbi të gjitha ka hartuar një sërë dokumentash në nivel institucional strategjik dhe operacional. Kolegji universitar TBU duhet të rrisë fokusin e kërkimit shkencor dhe misionit të tretë të universitetit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi i Avancuar”, me 120 kredite dhe me tre profile në TBU, dosjes përkatëse së syllabuseve, por edhe nga konfirmimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se format e mësimdhënies për këtë program specifik janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit/estetë dhe praktika profesionale. Gjithashtu, konstatohet se institucioni nxit edhe zhvillimin e leksioneve të hapura me specialistë të fushës. Referuar RVB dhe rregullores së këtij programi studimi (neni 4, pika b), plani mësimor i këtij programi studimi parashikon realizimin gjatë dy viteve akademik të 3'000 orëve mësimore të shpërndara si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 900 orë mësimore në auditor leksione, seminare, ushtrime & detyra kursi/ese; ▪ 2'100 orë punë e individuale jashtë auditorit, praktikë & diploma. <p>Totali 3000 orë</p> <p>Kjo shpërndarje reflektohet edhe në dokumentacionin shoqërues të vendimit të Senatit Akademik të TBU për ndryshimet në planin mësimor të këtij programi studimi për vitin akademik 2024-2025, të konfirmuara me shkresën e MAS nr. 3106/3, datë 12.07.2024. Ndërkohë në dokumentacion shtesë të paraqitur, plani mësimor i këtij programi studimi</p>

	<p>parashikon realizimin gjatë dy viteve akademike të 3'000 orëve mësimore të shpërndara si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 900 orë mësimore në auditor leksione, seminare, ushtrime & detyra kursi/ese; ▪ 26 orë mësimore në auditor, praktikë & diploma; ▪ 2074 orë punë e individuale jashtë auditorit, praktikë & diploma. <p style="text-align: center;">Totali 3000 orë</p> <p><u>GVJ sugjeron se praktika rregullatore e TBU dhe dokumentacioni që rezulton duhet të jenë të unifikuar dhe të përditësuar për këtë aspekt.</u></p> <p>Në syllabusin e çdo lënde është i përfshirë informacioni në lidhje me numrin e orëve të leksioneve, seminareve dhe projekteve/detyrave. Në syllabus është e përcaktuar edhe mënyra e vlerësimit të studentëve me pikë (në %) dhe notë (vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi final), si dhe detyrimet për frekuentim të lëndës në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të TBU.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; 16. Kurrikula e programit MP Administrim Biznesi i Avancuar 120 (shqip).pdf; 16.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MP Administrim Biznesi i Avancuar" 120.pdf; 16.5. Shkresa TBU, nr.55.dt.10.5.24 _Dergohet ne MAS Vendimi senatit &planet 24-25 (per ndryshim brenda 20%).pdf; 16.6. Shkresa e MAS Konfirmimi i ndryshimeve ne planin e lendeve te programeve MP60&MP120 24-25.pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; Info shtese: 16.2. Plani mësimor i programit të studimit MP Administrim Biznesi" 120 (shqip); vizita ne institucion;</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ mori konfirmimin se personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta dhe pa dallime diskriminuese, për të gjithë studentët në arritjen e objektivave të tyre akademike.</p> <p>Në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies, duke integruar teknologjinë në mësimdhënie</p>




<p>të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>dhe duke nxitur përfshirjen aktive të studentëve përmes projekteve dhe detyrave të kursit, punës në grup për të nxitur diskutimet dhe bashkëpunimin sipas roleve, si dhe për të përmirësuar programin e studimit në bazë të reagimeve dhe opinionëve të studentëve. Po kështu edhe studentët u shprehën pozitivisht për procesin mësimor duke konfirmuar ekzistencën e formave dhe mënyrave të ndryshme alternative të mësimi, sidomos formave të reja të mundësuar edhe me ndihmën e teknologjisë.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson angazhimin e TBU në mbështetjen e personelit akademik për plotësimin dhe përmirësimin e kompetencave didaktike përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të huaja, për shkëmbime eksperience dhe organizimit të trajnimeve dhe leksioneve të hapura për personelin akademik në institucion, politikës së granteve për kualifikim të mëtijshëm si dhe përmes hartimit të politikës për zhvillimin profesional të personelit akademik dhe të udhëzuesit në ndihmë të organizimit të procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 38.1. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik.pdf; 38.1.1. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin.pdf; 43.2. Politika e granteve.pdf; 51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe jetëshkrimeve të personelit akademik, si edhe nga diskutimet me përfaqësues të tyre gjatë vizitës, GVJ formoi bindjen se TBU ka punësuar personel të përgatitur që është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të rëndësishme për këtë program studimi. Gjithashtu, GVJ konstatoi përdorimin e metodave të larmishme në mësimdhënie për të nxitur pjesëmarrjen e studentëve në</p>

<p>interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>procesin mësimor duke kombinuar leksionet, me detyrat, rastet praktike dhe projektet e kursit.</p> <p>Por siç u përmend edhe në Standardin II.2, GVJ konstaton se gjatë viteve akademike 2022-2025 në këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie edhe pedagogë me kualifikimet Master i Shkencave.</p> <p>P.sh. gjatë vitit akademik 2023-2024, për këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej 22 pedagogë nga të cilët 5 pedagogë i përkasin kategorisë Profesor, 9 pedagogë i përkasin kategorisë Lektor dhe mbajnë gradën Doktor, ndërsa 8 pedagogët e tjerë të kategorisë As.Lektor mbajnë kualifikimin Master i Shkencave.</p> <p><i>Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 dhe udhëzimeve që burojnë prej tij, në programet e ciklit të dytë, mësimdhënia duhet të realizohet nga staf akademik që mban të paktën gradën doktor në fushën përkatëse të mësimdhënies.</i> <u><i>Prandaj GVJ rekomandon që institucioni duhet të marrë masat që në mësimdhënien e këtij programi studimi të angazhohet staf akademik me kualifikimin doktor shkencash e lart.</i></u></p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; 24. CV e stafit akademik të angazhuar në programet e studimit MP.pdf; vizita ne institucion;</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet përfaqësimit të tyre në Senat dhe në Këshillat studentorë, si edhe nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve të vlerësimit të procesit mësimor dhe pjesëmarrjes në fokus grupe.</p> <p>Referuar dokumentacionit shoqërues të RVB, pyetësori me studentët fokusohet në vlerësimin e organizimit dhe objektivave të lëndës, performancës së pedagogëve, metodave të mësimdhënies, aktivitetet, metodat e vlerësimit, komente, e sugjerime të tjera nga studentët. Praktika e plotësimit të pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor u konfirmua</p>

	<p>edhe nga studentët e programit të studimit gjatë takimit të zhvilluar në institucion.</p> <p>Mbi rezultatet e pyetësorëve dhe të takimeve me fokus grupet, Njësia e brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) e TBU, përgatit një raport në nivel institucional i cili u komunikohet strukturave drejtuese të TBU dhe departamentit përgjegjës për ofrimin e programit të studimit që i përfshin në analizat përkatëse me qëllim përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së këtyre metodave.</p> <p><i>Referenca:</i> 36.5. Raporti vjetor i NJSBC 24-23.pdf; 41. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MP120.pdf; 36.9. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët.pdf; 36.10. Raporti i Fokus Grupeve.pdf; 70.1. Raporti vjetor I DBF 23-24.pdf; vizita ne institucion;</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstatoi se monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga bashkëpunimi mes strukturave si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC); ▪ Komisioni i Përhershëm i Cilësisë në nivel Fakulteti (KC); ▪ Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për programin e studimit; <p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) e zhvillon aktivitetin në përputhje me rregulloren përkatëse dhe në bashkëpunim me strukturat e mësipërme ndjek të gjitha problemet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në TBU me fokus procedurat, politikat dhe aktivitetet e lidhura me cilësinë, si dhe dokumentacionin përkatës në nivel institucioni.</p> <p>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e strukturuar për vlerësimin anonim nga studentët të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave pedagogjike të përdorura. Gjithashtu përdoren edhe analizat e përvojës studentore përmes fokus grupeve, si dhe analizat e ecures të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe TBU (analizat vjetore përkatëse). Në nivel departamenti mekanizmat e vlerësimin përfshijnë edhe vlerësimin/ndjekjen e procesit të mësimor nga drejtuesi i departamentit ose pedagogë me eksperiencë etj.</p>

	<p>Komisioni i Përhershëm i Cilësisë në nivel Fakulteti (KC) e zhvillon aktivitetin në përputhje me parashikimet në kuadrin rregullator të TBU dhe ka për detyrë garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe të programit të studimit. GVJ konstatoi se Statuti i TBU parashikon edhe ngritjen e Komisionit të Përhershëm të Cilësisë në nivel institucioni dhe të Zyrës së Kurrikulave, por nuk konstatoi ndonjë dokument lidhur me veprimtarinë apo kontributin e realizuar prej tyre në nivel TBU.</p> <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni mbështet personelin akademik në kualifikimin e vijueshëm me objektiv përmirësimin dhe implementimin e metodave të reja të mësimdhënies përmes aplikimit në mobilitete Erasmus, pjesëmarrjes në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përfshirjes në projekte të ndryshme pranë TBU.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 2. Statuti TBU.pdf; 20. Rregullore për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale.pdf; 34. Projektet e situara nga TBU-34.1.Projekte ku eshte perfshire DBF.pdf; 36.1. Rregullore NJSBC.pdf; vizita ne institucion;</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në këtë program studimi janë në përputhje me parashikimet në kuadrin rregullator në fuqi, por <u>praktika rregullatore e TBU dhe dokumentacioni që rezultojn duhet të jenë të unifikuar dhe të përditësuar për këtë aspekt.</u></i></p> <p><i>Gjithashtu, <u>TBU duhet të marrë masat që në mësimdhënien e këtij programi studimi të angazhohet staf akademik me kualifikimin "DR" e lart në përputhje me parashikimet në kuadrin rregullator në fuqi.</u></i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi se mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive e dijeve të studentëve përcaktohet në Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi i Avancuar” me 120 kredite dhe me tre profile. Vlerësimi përfshin vlerësimin e nivelit të pjesëmarrjes dhe diskutimit në seminarët, detyrat dhe projektet e kursit, vlerësimin e provimit/testimeve të ndërmjetme si edhe vlerësimin gjatë provimit përfundimtar të lëndës.</p> <p>Mënyra e vlerësimit të njohurive të studentëve gjithashtu ishte përfshirë si pjesë e syllabuseve (programeve lëndore). Në faqen zyrtare në internet të institucionit gjendet e publikuar Rregullorja e TBU, kreu 5-të i së cilës i referohet mësimdhënies dhe të kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të studentëve (nenet 21-22) dhe Rregullorja e këtij programi studimi.</p> <p><i>Referenca:</i> 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi i Avancuar” me 120 Kredite.pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; https://tbu.edu.al/rregullore/#; vizita ne institucion;</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentët, që në fillim të semestrit, njihen me të gjithë elementët e syllabusit përfshirë edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve nga pedagogu i lëndës. Syllabuset vendosen gjithashtu në dispozicion të studentëve që në fillim të semestrit në hapësirën e dedikuar në platformën LMS TBU dhe mund të disponohen prej tyre nëpërmjet emailit institucional me të cilin është i pajisur çdo student.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</p>

	22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; vizita ne institucion;			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Kuatridhe rregullator parashikon si forma të kontrollit dhe vlerësimit të nivelit të njohurive që studenti ka përvetësuar gjatë aktivitetit mësimor vlerësimin e nivelit të pjesëmarrjes dhe diskutimit në seminare, detyrat dhe projektet e kursit, vlerësimin e provimit/testimeve të ndërmjetme si edhe vlerësimin gjatë provimit përfundimtar të lëndës, praktikën dhe diplomën. Provimet/testimet janë me shkrim, kurse detyrat dhe projektet e kursit prezantohen para grupit mësimor. Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ krijoi bindjen se vlerësimi i studentëve realizohet në bazë të formave të parashikuara në kuadrin rregullator, duke u dhënë mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara.			
	Referenca: 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; vizita ne institucion;			
Konkluzione	GVJ konstaton se kuadri rregullator i TBU përfshin forma të ndryshme kontrolli dhe vlerësimi të cilat u bëhen me dije studentëve para fillimit të lëndës. Gjithashtu në faqen zyrtare në internet të institucionit gjendet e publikuar Rregullorja e TBU, kreu 5-të i së cilës i referohet mësimdhënies dhe të kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në

<p>aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi realizohet sipas parashikimeve në kuadrin rregullator të TBU. Konkretisht, vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi ishte pothuajse i harmonizuar (me përjashtim të tre lëndëve) dhe llogaritej sipas parashikimeve në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 10% e vlerësimit nga pjesëmarrja & diskutimet në seminare; ▪ 20% e vlerësimit nga detyrat/projektet e kursit; ▪ 30% e vlerësimit nga provimet/testimet e ndërmjetme; ▪ 40% e vlerësimit nga provimi përfundimtar i lëndës; <p><i>9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</i> <i>22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf;</i> <i>vizita ne institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ nuk konstatoi përdorimin e ndonjë sistemi elektronik testimi në funksion të këtij programi studimi. Aktualisht numri i ulët i studentëve nuk justifikon kostot e përdorimit të sistemeve elektronike të vlerësimit në këtë program studimi.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>01. TBU - Raporti i Vlerësimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</i> <i>vizita ne institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se provimet përfundimtare zhvillohen me shkrim dhe me procedurë sekretimi. Vlerësimi me notë bëhet mbështetur në totalin e vlerësimeve gjatë vitit dhe të provimit përfundimtar (Rregullorja e programit të studimit) dhe është sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me nota kaluese nga 5 deri në 10.</p> <p>Në nenin 11 të Rregullores së programit jepet një paraqitje e detajuar e tabelës së konvertimit të pikëve totale në nota (si dhe vlerësimi me shkronja). Kjo mënyrë vlerësimi përfshihet gjithashtu edhe në syllabuset e çdo lënde për të rritur transparencën e komunikimit me studentët dhe të tjerë të interesuar.</p>

	<p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; vizita ne institucion;</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se provimet përfundimtare zhvillohen me shkrim dhe në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p> <p>Gjithashtu, në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ mori konfirmimin se në TBU bëhet një korrigjim i kujdesshëm i provimeve përfundimtare, si edhe i provimeve të ndërmjetme, i detyrave/projekteve të kursit, duke u dhënë studentëve këshilla në funksion të përmirësimit të punës së tyre në të ardhmen.</p> <p><i>GVJ vëren se kuadri rregullator i TBU nuk parashikon ndonjë procedurë miratimi paraprak të tezës së provimit nga drejtuesi i njësisë bazë.</i></p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; vizita ne institucion;</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik monitorojnë me rigorozitet dhe përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën. Në Rregulloren e TBU (neni 29) parashikohen masat disiplinore në rastet e konstatimit të sjelljeve të dënueshme si kopjimi në provime dhe plagjiatura në punime shkencore. Kërkesat e Kodit të Etikës janë përfshirë edhe në syllabuset.</p>
	<p><i>Referenca:</i> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf;</p>

<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p><i>vizita ne institucion;</i></p> <p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ mori konfirmimin se në TBU bëhet një korrigjim i kujdesshëm i provimeve përfundimtare. Rregullorja e TBU (neni 27) parashikon një afat komunikimi të rezultateve dhe të dorëzimit të procesverbaleve të provimit nga 7 deri në 15 ditë nga data e zhvillimit të provimit. Komunikimi i rezultateve bëhet nga sekretaria mësimore përmes emailit të secilit student brenda 3 ditëve nga dorëzimi i rezultateve nga pedagogu i lëndës dhe parashikohet e drejta e studentit për ankesë në një seancë sqaruese që zhvillohet pas provimit nga pedagogu i lëndës.</p> <p><i>GVJ konstaton se kuadri rregullator nuk specifikon afate kohore lidhur me organizimin e seancës sqaruese. Pavarësisht se në kushtet aktuale, me një numër të ulët studentësh, institucioni mund t'i menaxhojë në kohë të gjitha ankesat, <u>GVJ rekomandon plotësimin e kuadrit rregullator me afate kohore të qarta për këtë çështje.</u></i></p> <p><i>Referenca:</i> <i>Referenca: 5.Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf;</i> <i>vizita ne institucion;</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në Rregulloren e TBU (neni 28) parashikohet procedura e ankesës për pikët që studenti ka marrë në një nga elementët e vlerësimit, pasi ka përfunduar seancën sqaruese me pedagogun e lëndës.</p> <p>Konkretisht, studenti duhet t'i drejtohet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit ose Dekanit të cilët ngrënë një komision rivlerësimi me tre pedagogë. Komisioni shqyrton ankesën dhe bën rivlerësimin e elementit të ankimuar.</p> <p><i>GVJ konstaton se edhe në këtë rast kuadri rregullator i TBU nuk specifikon afate kohore të qarta lidhur me këtë proces.</i></p> <p><i>Referenca:</i> <i>01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</i> <i>9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</i> <i>vizita ne institucion;</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, theksohet se praktika e ankesës dhe vendimi i komisioni të rivlerësimit</p>

<p>komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>depozitohen në sekretarinë e FBD dhe në Dekanat. Siç u përmend edhe më sipër GVJ konstaton se kuadri rregullator i TBU nuk specifikon afate kohore të qarta lidhur me këtë proces. Gjithashtu, kuadri rregullator nuk parashikon as dokumentimin dhe as arkivimin e dokumentacionit të procesit.</p> <p><i>Pavarësisht se në kushtet aktuale, me një numër të ulët studentësh, institucioni mund t'i menaxhojë në kohë të gjitha ankesat, <u>GVJ rekomandon plotësimin e kuadrit rregullator me afate kohore të qarta, si dhe procedura dokumenti dhe arkivimi edhe për këtë çështje.</u></i></p> <p><i>Referenca:</i> <i>01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</i> <i>9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</i> <i>vizita në institucion;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi realizohet sipas parashikimeve në kuadrin rregullator të TBU.</i></p> <p><i>Por GVJ vlerëson se <u>kuadri rregullator i TBU ka nevojë të përditësohet me afate kohore më të qarta lidhur me procedurën e ankimimit si dhe të plotësohet me procedura për dokumentimin dhe ruajtjen e praktikës së ankimimit.</u></i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi III.4</p>	
<p>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 kredite dhe me tre profile është konceptuar të zhvillohet në katër semestra, përgjatë dy viteve akademike. Lëndët e përfshira në këtë program u mundësojnë studentëve marrjen e njohurive të thelluara në fushën e menaxhimit, financës dhe të kontabilitetit fokusuar në disiplina si menaxhimi</p>

strategjik, sjellja organizative dhe lidershpi, drejtim financiar i avancuar, taksim i biznesit dhe auditim i avancuar.

Duke iu referuar planit mësimor të programit të paraqitur në dosjen shoqëruese të RVB dhe Rregullores së këtij programi studimi (neni 8), *GVJ konstatoi se plani mësimor parashikon mundësinë e zgjedhjes së 8 lëndëve të kategorisë B kundrejt 10 lëndëve të parashikuara në planin mësimor, praktikë e ndjekur në vitet akademike të mëparshme (2021-2024).*

Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në TBU me drejtuesit dhe personelin akademik të këtij programi studimi, GVJ vuri në dukje se sipas kuadrit ligjor në fuqi, praktika e lëndëve me zgjedhje parashikohet vetëm për lëndët ndërdisiplinore ose integruese të kategorisë C në planet mësimore të programeve të studimit master professional. Në diskutime doli në pah se kjo ishte një praktikë e trashëguar nga e kaluara dhe se që prej vitit 2024 drejtuesit në bashkëpunim me pedagogët e këtij programi studimi kanë marrë masat për sistemimin e planit mësimor, përmes ndryshimeve brenda hapësirave të lejuara dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Konkretisht, me vendimin nr. 2, datë 20.03.2024 të Senatit të TBU janë miratuar ndryshimet e nevojshme në planin mësimor të këtij programi studimi për vitin akademik 2024-2025 dhe është marrë miratimi për to nga MAS me shkresën nr. 3103 prot, datë 20.07.2024. GVJ konstaton se në planin mësimor të rishikuar për vitin akademik 2024-2025 (dok. 56), veprimtaritë formuese të programit (puna në auditor dhe jashtë tij) janë përcaktuar në funksion të formimit të studentëve, në zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të tyre.

GVJ rekomandon përditësimin e kuadrit rregullator të TBU në përputhje me ndryshimet e miratuara në planet mësimore të këtij programi studimi.

Referenca:

01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;

9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;

16.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MP Administrim Biznesi i Avancuar" 120.pdf;

22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf;

	<p>6.1. Procedura e ndjekur për ndryshimet e e kurrikulës MP60 & MP120.pdf; Dok shtesë. 16.2. Plani mësimor i programit të studimit MP „ Administrim Biznesi“ 120 (shqip); vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimet (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Përfshirja në planin mësimor të këtij programi studimi të lëndëve si “Menaxhim i sistemeve të informacionit i avancuar”, “Menaxhim projektesh” dhe “Auditim i avancuar” u mundëson studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe analizës kritike. Por GVJ konstaton se plani mësimor i këtij programi studimi nuk parashikon realizimin e orëve laboratorike të detyrueshme në këto lëndë.</p> <p><u>GVJ rekomandon që syllabuset e këtyre lëndëve duhet të rishihen dhe të reflektojnë aplikimin praktik të njohurive në orë laboratorike të detyrueshme.</u></p> <p><i>Referenca:</i> 16.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MP Administrim Biznesi i Avancuar“ 120.pdf; 16.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MP Administrim Biznesi i Avancuar“ 120.pdf; 56. Ndryshimet e kurrikulës MP120 (Aneks Tabela 11).pdf; 56.1 Procedura e ndjekur për ndryshimet e e kurrikulës MP60 & MP120.pdf; Dok shtesë. Plani mesimor MSh 24-25.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se kompetencat dhe aftësitë e studentit në këtë program studimi vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë zhvillimit të programit mësimor nëpërmjet diskutimeve në leksione dhe seminare, realizimit të detyrave/projekteve të kursit, si edhe në përfundim të lëndës me provimin përfundimtar.</p> <p>Gjithashtu, në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se në përfundim të çdo lënde, pedagogu përkatës informon studentët mbi vlerësimin e vazhdueshëm të fituar gjatë semestrit si dhe mbi strukturën e provimit dhe çështjet kryesore ku duhet të fokusohen për provimin përfundimtar.</p> <p><i>Referenca:</i> 16.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MP Administrim Biznesi i Avancuar“ 120.pdf;</p>

<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p><i>vizita ne institucion;</i></p> <p>Duke iu referuar planit mësimor të programit të studimit dhe syllabuseve, GVJ konstaton se lënda “Menaxhim i Sistemeve të Informacionit i Avancuar” u mundëson studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë. Por siç u theksua edhe më sipër, syllabusi përkatës nuk parashikon orë laboratorike të detyrueshme. <u>Prandaj GVJ rekomandon rishikimin e këtij syllabusi.</u></p> <p>Gjithashtu, praktika profesionale e parashikuar si detyrim akademik për t'u realizuar në semestrin e dytë, u mundëson studentëve të zhvillojnë aftësitë profesionale përmes zbatimit në një mjedis profesional real të njohurive teorike të marra në auditor. Në takimin, gjatë vizitës në institucion, me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi i Avancuar” me 120 kredite dhe me 3 profile, GVJ konstatoi se ata mbështesin dhe nxisin diskutimet kritike të studentëve brenda kuadrit të këtij program studimi. Syllabuset, të hartuara dhe zhvilluara prej tyre, nxisin bashkëpunimin dhe punën në grup të studentëve përmes projekteve të kursit, prezantimeve të ndryshme, analizës së rasteve studimore dhe realizimit të vizitave studimore pranë bizneseve.</p> <p><i>Referenca:</i> 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; <i>vizita ne institucion;</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në bashkëpunim me Zyrën e Studentit personeli akademik i këtij programi studimi ka zhvilluar leksione të hapura me profesionistë të ftuar mbi zhvillimet më të fundit sipas fushave të tyre të ekspertizës, si dhe me lektorë të huaj në kuadrin e projekteve të institucionit.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 14.3. Aktivitete të realizuara nga zyra për studentët.pdf; 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët.pdf; <i>vizita ne institucion;</i></p>


<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Gjithashtu, bazuar në sa më sipër GVJ vlerëson angazhimin e TBU në mbështetjen e studentëve përmes politikës së bursave, përfshirjes në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit, si pjesë e drejtimeve strategjike, të nxitjes dhe mbështetjes së studentëve në biznes, angazhimin e studentëve më të mirë në projekte të kërkimit shkencor dhe shfrytëzimin e infrastrukturës dhe ekspertizës së Grupit Balfin në funksion të realizimit të objektivave të institucionit.</p> <p><u>Megjithatë, GVJ nuk konstatoi ndonjë mbështetje konkrete apo specifike për këtë program studimi lidhur me kërkesën e këtij kriteri, përtej angazhimit të deklaruar dhe bursave në nivelin bachelor.</u></p> <p>Referenca: 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 79.3. Të dhëna për shpërndarjen e bursave ndër vite.pdf; 79.4. Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23.pdf; 79.5. Kontratë dhurimi Mane Foundation_TBU studenti Klejvi Pero 24-25.pdf; 79.6. Skema e bursave sociale në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se <u>kuadri rregullator i TBU duhet të përditësohet në përputhje me ndryshimet e miratuara në planet mësimore të këtij programi studimi.</u></p> <p>Gjithashtu, <u>GVJ rekomandon se plani mësimor duhet të përfshijë realizimin e orëve laboratorike të detyrueshme për t'u mundësuar studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit.</u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në dokumentacionin shoqëruar konstatohet se procedura për</p>

<p>detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>mënyrën e diplomimit të studentëve parashikohet në Rregulloren e TBU (nenet 35-37).</p> <p>Për programet e ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional”, kjo rregullore parashikon diplomimin përmes një provimi formimi ose përgatitjes dhe mbrojtjes së një punimi diplome. Sipas rregullores, pranë TBU organizohen dy sezona diplomimi për çdo vit akademik (në verë dhe në vjeshtë), datat e të cilëve përcaktohen nga Rektori me propozim të drejtuesit të njësisë kryesore. Studenti ka të drejtë të hyjë në sezonin më të afërt të diplomimit pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e programit mësimor para diplomimit. Rregullorja e TBU është e publikuar në faqen zyrtare në internet të institucionit.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar “TBU” pdf; https://tbu.edu.al/rregullore/#; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Përveç sa është parashikuar në Rregulloren e TBU, institucioni ka përgatitur edhe një udhëzues për studentët në lidhje me përgatitjen e temës së diplomës dhe formatin e tezës së provimit përfundimtar. Këto dokumenta përmbajnë orientime për studentët në varësi të mënyrës së diplomimit.</p> <p>Në takimin e zhvilluar me studentët e programit të studimit, gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se informacioni në lidhje me shlyerjen e detyrimeve përmbyllëse të programit të studimit, u vihet në dispozicion studentëve përpara fillimit të përgatitjes së tyre për diplomim. Aktualisht studentët e këtij programi studimi zgjidhnin diplomimin përmes një provimi përfundimtar.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 5.Rregullore e Kolegjit Universitar “TBU”.pdf; 10. Formatit i tezës së provimit përfundimtar.pdf; 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës (me anekse).pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në</p>	<p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i TBU nuk parashikon në mënyrë specifike organizimin dhe komisionin për administrimin e provimit përfundimtar. Referuar RVB dhe</p>

<p>testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>informacionit të marrë gjatë takimeve në institucion, diplomimi pranë këtij programi studimi realizohej përmes një provimi përfundimtar, me pyetje të aplikueshme mbi një rast studimor të konceptuar në përputhje me profilin e zgjedhur të programit të studimit master nga studenti.</p> <p><u><i>GVJ vlerëson praktikën aktuale të diplomimit të departamentit BF, por rekomandon që kuadri rregullator i TBU duhet të gartësohet lidhur me organizimin dhe komisionin për administrimin e provimit përfundimtar.</i></u></p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 5..Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf; 10. Formati i tezës së provimit përfundimtar.pdf; vizita ne institucion;</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, institucioni ka përgatitur edhe një udhëzues për studentët në lidhje me përgatitjen e temës së diplomës dhe formatin e tezës së provimit përfundimtar. Këto dokumenta përmbajnë orientime për studentët në varësi të mënyrës së diplomimit. Aktualisht studentët e këtij programi studimi zgjidhnin diplomimin përmes një provimi përfundimtar.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 5..Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf; 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës (me anekse).pdf; vizita ne institucion;</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Aktualisht studentët e këtij programi studimi zgjidhnin diplomimin përmes një provimi përfundimtar, prandaj ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf;</p>

<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p><i>vizita ne institucion;</i></p> <p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i TBU nuk parashikon në mënyrë specifike mënyrën e vlerësimit të provimit përfundimtar. Referuar RVB dhe informacionit të marrë gjatë takimeve në institucion, rezulton se vlerësimi realizohet sipas procedurave të parashikuara në kuadrin rregullator të TBU edhe për provimet e tjera. Rregullorja e TBU (neni 21) dhe Rregullorja e këtij PS (neni 11) parashikojnë sistemin e vlerësimit me notë (dhe ekuivalentet në germa), ku notat kaluese janë nga 5 deri në 10.</p> <p><u>GVJ rekomandon që kuadri rregullator i TBU duhet të përditësohet edhe për këtë aspekt.</u></p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 5 Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf; Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; <i>vizita ne institucion;</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ konstaton se në përfundim të studimeve në programin Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar", me 120 kredite dhe me tre profile, pasi studenti ka përfunduar të gjitha detyrimet e programit të studimit, si dhe detyrimet financiare ndaj TBU pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e diplomës sipas modelit të miratuar.</p> <p>Emërtimi dhe suplementi i diplomës janë në përputhje me programin e studimit të ndjekur nga studenti dhe me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Me kërkesë të studentëve vihet në dispozicion të tyre syllabusi për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf; 17.1. Modeli i diplomës _Modeli i Suplementit të Diplomës _për secilin profil per MPABA120.pdf; 17.2. Forma e re e propozuar e diplomës dhe suplementit _për secilin profil per MPABA120.pdf; <i>vizita ne institucion;</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në</p>

<p>në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se pranë sekretarisë mësimore të TBU ruhet i gjithë dokumentacioni mbi studentët, në formën e dosjeve personale edhe pas diplomimit, në arkivën përkatëse bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky dokumentacion i vihet në dispozicion studentit me kërkesën e tij dhe mund të përdoret për konfirmime ndaj personave të autorizuar.</p> <p><i>Referenca:</i> TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; vizita në institucion;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i TBU parashikon procedurat që ndiqen për përgatitjen për detyrimet përmbyllëse të këtij programi studimi, por ka nevojë të qartësohet me kërkesat specifike për organizimin dhe vlerësimin e këtyre detyrimeve përmbyllëse.</p>			
<p>Shkalla e përmbylljes së standardit</p>	<p>Nuk përmbyllet</p>	<p>Përmbyllet pjesërisht</p>	<p>Përmbyllet kryesisht</p>	<p>Përmbyllet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Sipas RVB, Departamenti i Biznesit dhe Financës (DBF) në TBU që është njësi përgjegjëse që e ofron këtë program studimi, përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura me njësi ekonomike, institucione dhe organizata të tjera, publike dhe private, garanton mundësitë e nevojshme për realizimin e praktikës profesionale pranë institucioneve pritëse.</p> <p>Gjithashtu, TBU disponon edhe ambiente të brendshme (biblioteka, laboratorë) dhe sisteme informacioni (LMS TBU, SharePoint, internet) në dispozicion të kryerjes së aktiviteteve ndihmëse për studentët dhe praktikën profesionale të tyre. Gjatë vizitës në Institutin, GVJ konstatoi mbështetjen e institucionit</p>

	<p>për realizimin me sukses të praktikave profesionale nga studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 37. Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse).pdf; 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje të bashkëpunimit.pdf; vizita ne institucion;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>N / A</p>
<p>Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p><i>Në këtë kriter, GVJ po vlerëson vetëm për praktikat profesionale dhe jo për praktikat klinike apo stazhet të cilat nuk kanë lidhje me programin e studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar", me 120 kredite dhe me tre profile në TBU.</i></p> <p>Specifikat e kryerjes së praktikave profesionale për të gjitha programet e studimit pranë TBU, shprehen në Rregulloren e TBU (neni 33). Praktika profesionale e këtij programi studimi realizohet në semestrin e dytë të vitit të studimeve. Si rregull, vendi i praktikës sigurohet nga TBU, sipas profilit të programit të studimit dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura, por inkurajohet edhe kontributi i studentëve për gjetjen e vendeve të praktikave në përputhje me kriteret e cilësisë së TBU.</p> <p>Studentët duhet të kryejnë 100% të orëve të praktikës profesionale dhe duhet të respektojnë rregullat e institucionit pritës. Në përputhje me Planin Mësimor, praktika profesionale konvertohet në 12 kredite (ECTS). Gjatë procesit të praktikës studentët drejtohen nga personeli akademik i caktuar nga DBF dhe personi i caktuar nga ofruesi i praktikës. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një raport për praktikën e kryer, si pjesë e dosjes së studentit që më pas vlerësohet nga komisioni përkatës në datën e caktuar nga Departamenti së</p>

	<p>bashku me vlerësimet nga drejtuesi personel akademik dhe drejtuesi në vendin e praktikës. Kjo procedurë e parashikuar për organizimin dhe supervizimin e studentit gjatë procesit të praktikës, u konfirmua edhe nga takimet gjatë vizitës në TBU.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 5.Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; 37. Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse).pdf; vizita ne institucion;</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se TBU angazhohet në gjetjen e partnerëve për realizimin e praktikës profesionale të studentëve, sipas profilit të programit të studimit përmes lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit për këtë qëllim. Në përputhje me Planin Mësimor, praktika profesionale e studentit të këtij programi studimi vlerësohet dhe konvertohet në 12 ECTS.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në

kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

institucion GVJ konstaton se personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar", me 120 kredite dhe me tre profile, ka *kryesisht* nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të lëndëve mësimore. Numri dhe kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi për vitet 2021-2025 paraqitet si vijon:

Tituj/grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1	1	1	2	-	2	-
Prof.As.Dr	3	1	1	2	2	1	2	1
Dr/PhD	7	3	5	5	6	2	5	2
Magjistart	-	1	-	1	-	3	-	2
Msc	-	3	-	4	2	4	1	2
Në total	11	9	7	13	12	10	10	7

Raporti i stafit mësimdhënës si numër fizik për vitet akademike të sipërcituara është si vijon :

- për vitin akademik 2021-2022 55% PAE dhe 45% PAK;
- për vitin akademik 2022-2023 35% PAE dhe 65% PAK;
- për vitin akademik 2023-2024 55% PAE dhe 45% PAK;
- për vitin akademik 2024-2025 59% PAE dhe 41% PAK;

Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 dhe udhëzimet që burojnë prej tij, në programet e ciklit të dytë, mësimdhënia duhet të realizohet nga staf akademik që mban të paktën gradën doktor në fushën përkatëse të mësimdhënies.

GVJ konstaton se:

- për vitin akademik 2021-2022 15 % e stafit janë me Msc;
- për vitin akademik 2022-2023 20 % e stafit janë me Msc;
- për vitin akademik 2023-2024 27 % e stafit janë me Msc;
- për vitin akademik 2024-2025 17.6 % e stafit janë me Msc;


Për sa më sipër GVJ rekomandon që institucioni duhet të marrë masat që në mësimdhënien e këtij programi studimi të angazhohet vetëm staf akademik me kualifikimin doktor shkencash e lart.

Gjithashtu, GVJ konstaton se fusha akademike kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që

	<p>mbulon këtë program studimi është në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij. Pranë Departamentit të Biznesit dhe Financës (DBF), përgjegjës për këtë program studimi, nuk ka personel efektiv ose me kontratë të angazhuar në role ndihmëse akademike dhe/ose administrative.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 24. CV e stafit akademik të angazhuar në programet e studimit MP.pdf; 27. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2).pdf; 28. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit MPAB120 (Aneks Tabela 6,12,7 & 8).pdf; vizita në institucion;</p>																																				
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në RVB deklarohet se stafi akademik efektiv mbulon 70% të ngarkesës mësimore të këtij programi studimi, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Duke iu referuar dokumentacionit shoqërues të RVB dhe informacionet shtesë të marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mbulimi i ngarkesës nga stafi akademik në këtë program studimi për vitet akademike 2021-2025 paraqitet si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="571 1111 1361 1637"> <thead> <tr> <th>VITI</th> <th>PROFILI</th> <th>% PAE</th> <th>% PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="3">2024-2025</td> <td>MENAXHIM</td> <td>74%</td> <td>26%</td> </tr> <tr> <td>KONTABILITET</td> <td>74%</td> <td>26%</td> </tr> <tr> <td>E DREJTE BIZNESI</td> <td>67%</td> <td>33%</td> </tr> <tr> <td rowspan="3">2023-2024</td> <td>MENAXHIM</td> <td>72%</td> <td>28%</td> </tr> <tr> <td>KONTABILITET</td> <td>72%</td> <td>28%</td> </tr> <tr> <td>E DREJTE BIZNESI</td> <td>71%</td> <td>29%</td> </tr> <tr> <td rowspan="3">2022-2023</td> <td>MENAXHIM</td> <td rowspan="3">58%</td> <td rowspan="3">42%</td> </tr> <tr> <td>KONTABILITET</td> </tr> <tr> <td>E DREJTE BIZNESI</td> </tr> <tr> <td rowspan="3">2021-2022</td> <td>MENAXHIM</td> <td rowspan="3">61%</td> <td rowspan="3">39%</td> </tr> <tr> <td>KONTABILITET</td> </tr> <tr> <td>E DREJTE BIZNESI</td> </tr> </tbody> </table> <p>Vlen të theksohet se informacioni i paraqitur në tabelat shoqëruese të RVB për vitet akademike 2021-2023 paraqitet në total dhe jo sipas profileve. Gjithashtu, siç u komentua edhe në Standardet e pjesës III të këtij raporti, në këtë program studimi gjatë viteve akademike 2021-2024, në planin mësimor sipas veprimtarive formuese është zbatuar praktika e lëndëve me zgjedhje edhe për</p>	VITI	PROFILI	% PAE	% PAK	2024-2025	MENAXHIM	74%	26%	KONTABILITET	74%	26%	E DREJTE BIZNESI	67%	33%	2023-2024	MENAXHIM	72%	28%	KONTABILITET	72%	28%	E DREJTE BIZNESI	71%	29%	2022-2023	MENAXHIM	58%	42%	KONTABILITET	E DREJTE BIZNESI	2021-2022	MENAXHIM	61%	39%	KONTABILITET	E DREJTE BIZNESI
VITI	PROFILI	% PAE	% PAK																																		
2024-2025	MENAXHIM	74%	26%																																		
	KONTABILITET	74%	26%																																		
	E DREJTE BIZNESI	67%	33%																																		
2023-2024	MENAXHIM	72%	28%																																		
	KONTABILITET	72%	28%																																		
	E DREJTE BIZNESI	71%	29%																																		
2022-2023	MENAXHIM	58%	42%																																		
	KONTABILITET																																				
	E DREJTE BIZNESI																																				
2021-2022	MENAXHIM	61%	39%																																		
	KONTABILITET																																				
	E DREJTE BIZNESI																																				




	<p>kategorinë B – Lëndë Karakterizuese dhe pranë TBU ishte praktikë zhvillimi i leksioneve së bashku me grupet e profileve të ndryshme. Kjo vështirëson llogaritjen e një treguesi sasior më objektiv për vlerësimin e këtij kriteri.</p> <p>Duke iu referuar informacionit shtesë për vitin akademik 2024-2025 GVJ konstaton përmirësimin e mbulimit të ngarkesës nga stafi akademik efektiv me përjashtim të profilit “E drejtë biznesi”. <u>Prandaj GVJ rekomandon që institucioni duhet të duhet të rrisë angazhimin e stafit akademik efektiv në këtë program studimi, si dhe duhet të përmirësojë dokumentacionin lidhur me raportimin e ngarkesës së realizuar nga secili pedagog sipas lëndëve dhe profileve të programit të studimit pasi kjo do të ndihmonte vlerësimin objektiv të plotësimin të kriterëve dhe të cilësisë së programit të studimit.</u></p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 28. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit MPAB120 (Aneks Tabela 6,12,7 & 8).pdf; 75. Mareveshja e MAS_TBU_dt.9.07.2024 _Përcaktimi i Personeli Akademik.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Kuadri rregullator i TBU parashikon angazhimin e personelit akademik efektiv kundrejt kontratës individuale të punësimit me kohëzgjatje të pacaktuar për kategorinë lektor dhe profesor dhe me kohëzgjatje një vit (e rinovueshme) për kategorinë asistent lektor, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.</p> <p>Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion dhe nga shqyrtimi i informacionit shoqërues të RVB, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është relativisht i qëndrueshëm. Konkretisht në vitet akademike 2021-2024, rreth 1/3 e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi kanë vijuar mësimdhënien pa ndërprerje në këtë program.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 24. CV e stafit akademik të angazhuar në programet e studimit MP.pdf; 28. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit MPAB120 (Aneks Tabela 6,12,7 & 8).pdf; vizita në institucion;</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e punësimit dhe të vlerësimit të personelit parashikohen në Statutin e TBU, në “Rregulloren për Punësimin etj” të TBU dhe në dokumentin “Politika e Burimeve Njerëzore në TBU”. Rregullorja për Punësimin dhe Politika për BNJ përcaktojnë qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve përmes konkurrimit, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. Kriteret specifike të rekrutimit propozohen nga departamenti përkatës, miratohen nga Dekani i FBD dhe i përcillen Rektorit për miratim. i gjithë procesi i rekrutimit ndiqet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe informacioni përkatës publikohet në faqen zyrtare në internet të TBU dhe në rrjetet sociale.</p> <p><i>Referenca:</i> 2. Statuti TBU.pdf; 13. Rregullore për Punësimin, Largimin nga Puna dhe Vlerësimin e Personelit Akademik, N.pdf; 13.1. Shembull njoftim për vend vacant për staf akademik në website.pdf; 13.3. Politika e BNJ ne TBU.pdf; https://tbu.edu.al/rrreth-nesh/#punesimi-ne-tbu; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se angazhimi i personelit ndihmës në këtë institucion ishte në nivele minimale për shkak edhe të numrit të kufizuar të studentëve.</p> <p>Aktualisht pranë DBF nuk ka të angazhuar personel akademik ndihmës dhe/ose administrativ. Mirëmbajtja e laboratorëve dhe ambienteve mësimore realizohet nga personeli akademik dhe personeli administrativ në nivel institucioni.</p> <p><u>GVJ rekomandon që institucioni duhet të rrisë angazhimin e personelit ndihmës akademik dhe /ose administrativ, në nivel njësie bazë dhe programesh studimi pasi kjo do të ndihmonte jo vetëm logjistikën e programeve por edhe cilësinë e dokumentacionit që përgatitet në përgjigje të kërkesave në rritje për informacion nga grupe të ndryshme interesi.</u></p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 27. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2).pdf; vizita në institucion;</p>

<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore në TBU është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit me kohë të plotë dhe me kontratë. Veprimtaria e zyrës mbështetet në kuadrin rregullator në fuqi, në Statutin, në “Rregulloren për Punësimin etj” dhe në dokumentin “Politika e BNJ” në TBU.</p> <p>Gjatë takimit me përfaqësuesen e kësaj zyre, GVJ konstatoi se kjo zyrë plotëson, ruan dhe përditëson të dhënat mbi anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron TBU në formën e dosjeve personale të personelit. Në mënyrë rastësore, GVJ shqyrtoi dosjen personale të dy pedagogëve të programit të studimit (një me kohë të plotë dhe një me kontratë) dhe konstatoi se dosja ishte e plotësuar me dokumentet e nevojshëm si: CV, kontrata e punës, diplomat dhe kualifikimet, librezat shëndetësore, etj.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 13.3. Politika e BNJ në TBU.pdf; 27. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2).pdf; 48. Format Dosje staf akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAKPAE).pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas</p>	<p>GVJ konstatoi se në nivel institucioni janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me sipërmarrje private, institucione dhe organizata për realizimin e praktikës profesionale të studentëve, të parashikuar në programin e studimit. Departamenti i BF në bashkëpunim me Zyrën e Çështjeve Studentore u mundëson studentëve gjetjen dhe mbikëqyrjen e duhur të praktikës profesionale. Pedagogu drejtues për praktikën përcaktohet në fillim të çdo viti akademik me vendim të Dekanit të FBD.</p> <p><i>Referenca:</i> 5 Rregullore e Kolegjit Universitar “TBU”.pdf; 37. Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse).pdf; 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje të bashkëpunimit.pdf; 39. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit MP120.pdf; vizita në institucion;</p>




natyrës së programit të studimit.									
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, ata konfirmuan se institucioni u kishte ofruar mbështetje për gjetjen e vendit të praktikës, megjithëse shumica e kishte gjetur vetë, pasi ishin të punësuar që gjatë viteve të studimit. Pjesë integrale e rregullores së miratuar për praktikën mësimore në TBU janë formularët e aplikimit, miratimit dhe të vlerësimit si dhe modeli i raportit mbi zhvillimin e praktikës që ndihmojnë studentët në realizimin e sukseshëm të saj dhe u mundësojnë mbikëqyrësve në vendin e praktikës të marrin pjesë në procesin e vlerësimit të studentit.</p> <p><i>Referenca:</i> 37. Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse).pdf; 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje të bashkëpunimit.pdf; vizita në institucion;</p>								
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi për vitet akademike 2021-2025 ka kryesisht nivelin e kërkuar të kualifikimit akademik për mësimdhënie në programe studimi Master dhe ka qenë relativisht i qëndrueshëm.</i></p> <p><i>Duke vlerësuar ndryshimet pozitive në vitin e fundit akademik, GVJ rekomandon që institucioni duhet të tregojë kujdes të shtuar në angazhimin e stafin akademik me grada e tituj për këtë program studimi si dhe duhet të rrisë angazhimin e personelit ndihmës akademik dhe /ose administrativ.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se TBU ka mjedise të

përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.

Përmbledhtas të dhënat për mjediset në dispozicion të studentëve dhe personelit pranë TBU paraqiten si vijon:

Mjedisi	Nr. Sallash
Salla leksioni	9
Salla seminari	8
Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	3
Zyra për personelin & drejtuesit	6
Bibliotekë	1
Ambiente ndihmëse: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zyra informacioni/sekretaria /financa/IT etj. ▪ Mjedise shërbimi/fotokopje 	6

Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se mësimi zhvillohej pasdite, gjatë ditëve të javës, nga e hëna në të premte, sipas orarit mësimor të publikuar në fillim të çdo semestri.

Referenca:

01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;

44. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (22-23).pdf; 44.1. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024).pdf; 44.2. Mjediset e Fakultetit Njësive Bazë (Aneks Tabela 16).pdf; vizita në institucion;

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë

Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje të teknologjisë së informacionit që garantojnë lidhjen me internet sipas nevojave të përdoruesve.

Sallat e leksionit dhe laboratorët janë të pajisura me videoprojektorë, tabela bashkëkohore, kompjutera dhe vende pune me internet.

<p>realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 44.2. Mjediset e FakultetitNjësive Bazë (Aneks Tabela 16).pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje të teknologjisë së informacionit që garantojnë lidhjen me internet sipas nevojave të përdoruesve.</p> <p>Sallat e leksionit dhe laboratorët janë të pajisura me videoprojektorë, tabela bashkëkohore, kompjutera dhe vende pune me internet. Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi i Avancuar”, me 120 kredite dhe me profile në “Menaxhim”, në “Kontabilitet-Financë” dhe në “E Drjetë Biznesi” nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar dhe nuk parashikon orë të detyrueshme laboratorike.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 44.2. Mjediset e FakultetitNjësive Bazë (Aneks Tabela 16).pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se megjithëse programi i studimit nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar, studentët pranë TBU kanë në dispozicion 2 laboratorë që mund t’i përdorin për realizimin e detyrave të kursit, përgatitjen e temës së diplomës, apo për aftësimin e pavaruar individual në module dhe programe aplikative.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 44.2. Mjediset e FakultetitNjësive Bazë (Aneks Tabela 16).pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB si dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel institucioni me përfaqësues të sipërmarrjeve private, institucione publike dhe organizata jofitimprurëse të cilat</p>

<p>tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>mundësojnë edhe realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi në mjedise të përshtatshme.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</i> <i>37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje të bashkëpunimit.pdf;</i> <i>vizita në institucion;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se TBU ka ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një proces mësimor bashkëkohor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar të RVB, GVJ konstatoi se literatura bazë dhe ndihmëse e rekomanduar në syllabuset e programit të studimit është në përputhje me nevojat për dije dhe njohuri të parashikuara për studentët e ciklit master.</p> <p>Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj. Krahas literaturës në gjuhën shqipe, në syllabus studentëve u sugjerohet edhe literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj (në gjuhën angleze) në funksion të thellimit të njohurive të fushës.</p>

	<p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; 49.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MPAB120.pdf; 49.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të RVB dhe nga takimi me personelin akademik, GVJ mori konfirmimin se në fillim të çdo viti akademik, pedagogët bëjnë rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve të lëndëve dhe secili departament paraqet propozimin për listën e librave të nevojshëm për procesin mësimor dhe që duhet t'i shtohen fondit të bibliotekës.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; 49.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MPAB120.pdf; 49.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni vë në dispozicion të të gjithë studentëve dhe personelit të tij, bibliotekën e TBU. Salla e bibliotekës me sipërfaqe 88 m² ndodhet në katin e parë të godinës dhe është e organizuar me vende për studim, lidhje interneti wi-fi dhe vende pune të pajisura me kompjutera për shfrytëzimin e burimeve online. Biblioteka mund të shfrytëzohet njëjloj nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 49. Rregullore e Bibliotekës.pdf; 49.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MPAB120.pdf; 51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka</p>

<p>fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të TBU si: tekste mësimore bazë dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, periodikë dhe botime të institucioneve të tjera. Aktualisht biblioteka ishte në proces restaurimi dhe institucioni po punonte për rinovimin e shërbimit të bibliotekës online, që më parë ka qenë në përdorim përmes platformës EBSCO.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 49. Rregullore e Bibliotekës.pdf; 49.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MPAB120.pdf; 51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se u mundëson akses të barabartë dhe të lirë në bibliotekën fizike dhe po punon për rinovimin e shërbimit të bibliotekës online, që më parë ka qenë në përdorim përmes platformës EBSCO.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf 49. Rregullore e Bibliotekës.pdf; 49.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MPAB120.pdf; 51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se u mundëson akses të barabartë dhe të lirë në bibliotekën fizike dhe po punon për rinovimin e shërbimit të bibliotekës online, që më parë ka qenë në përdorim përmes platformës EBSCO. Siç u përmend edhe më sipër, biblioteka ishte në proces restaurimi por salla e studimit e bibliotekës është e pajisur me teknologjinë e nevojshme (kompjuteri, videoprojektorë, lidhje wi-fi) të cilat mund të shfrytëzohen nga studentët dhe pedagogët në aktivitetet mësimore dhe kërkimore.</p> <p><i>Referenca:</i></p>

	<p>01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf 49. Rregullore e Bibliotekës.pdf; 49.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MPAB120.pdf; 51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ konstatoi se orari i shërbimit fizik të bibliotekës është 9.00-20.00 nga e hëna në të premte, në përputhje me nevojat e studentëve të këtij programi studimi por edhe të studentëve të programeve të tjera.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 49. Rregullore e Bibliotekës.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se TBU është i angazhuar në shtimin dhe përditësimin periodik të fondit të bibliotekës sipas kërkesave të departamenteve dhe në përputhje me procedurën e miratuar të blerjes së literaturës në TBU.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 49.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se literatura bazë dhe ndihmëse e programit përmbushin objektivat e tij të studimit dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program.</p>

	<i>Gjithashtu, TBU angazhohet në përditësimin e fondit të bibliotekës në përputhje me procedurën e miratuar të TBU.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se institucioni përdor disa platforma online (LMS TBU, Office 365 & SharePoint) për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre të kombinuar me sistemin tradicional të bazuar në dokumentacionin në formatin letër dhe elektronik dhe të dosjeve përkatëse të studentëve.</p> <p>Sipas kuadrit rregullator të TBU, informacioni që lidhet me studentët nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre administrohet nga sekretaria mësimore dhe dokumentacioni ruhet në formatin fizik dhe elektronik në sekretari. Gjatë vizitës në sekretari GVJ verifikoi dhe konstatoi përdorimin sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi të regjistrave për studentët e këtij programi studimi (themeltar, të arritjeve akademike & të lëshimit të diplomave).</p> <p><i>Referenca:</i> <i>01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</i> <i>8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore.pdf;</i> <i>51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.pdf;</i> <i>vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit</p>	<p>Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin për përdorimin e disa platformave për administrimin dhe komunikimin e informacionit në institucion si LMS TBU, Office 365 & SharePoint dhe faqja zyrtare në internet e TBU.</p>

<p>akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Departamenti i Biznesit dhe Financës menaxhon dokumentacionin lidhur me aktivitetin mësimor dhe kërkimor të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit ndërsa Zyra e Burimeve Njerëzore administron dosjet e plota personale të të gjithë personelit të TBU. Informacioni në dosjet përkatëse përditësohet rregullisht për të reflektuar ndryshimet e ndodhura në kualifikime, pozicione etj.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 2. Statuti TBU.pdf; 13. Rregullore për Punësimin, Largimin nga Puna dhe Vlerësimin e Personelit Akademik, N.pdf; 13.3. Politika e BNJ ne TBU.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platformat LMS TBU, Office 365 & SharePoint, garantojnë akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit në përputhje me ligjin e ruajtjes së të dhënave personale dhe me funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë TBU si: programet mësimore sipas cikleve të studimit, materialet e leksioneve dhe të seminareve, grafiku i provimeve, rezultatet e vlerësimeve etj.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Siç u përmend edhe mësipër, përmes platformave LMS TBU, Office 365 & SharePoint, emailit me adresë të dedikuar mundësohet komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë TBU si: programet mësimore sipas cikleve të studimit, materialet e leksioneve dhe të seminareve, grafiku i provimeve, rezultatet e vlerësimeve etj.</p> <p>SharePoint, kryesisht i referohet komunikimit të brendshëm dhe ruajtjes së dokumentave të kategorizuar sipas strukturave dhe të disponueshëm sipas hierarkisë së të drejtave në sistem. Faqja zyrtare në internet e TBU dhe rrjetet sociale përdoren për komunikimin me publikun e gjerë.</p>

	<p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të TBU, si dhe përditësimet e parashikuara për tu implementuar (sistemi Pitagora), garantojnë monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundësojnë evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstatoi se në faqen zyrtare në internet të TBU, informacioni publikohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Në momentin e hartimit të këtij raporti, faqja zyrtare ishte në proces përditësimi megjithatë gjendej i publikuar informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet që lidhen me procesin mësimor, projektet dhe aktivitetet kërkimore-shkencore, broshura të ndryshme promovuese të TBU, si dhe njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; https://tbu.edu.al/en/about-us/#rreth-tbu; vizita në institucion;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë TBU.</i></p> <p><i>Gjithashtu, edhe pse në proces përditësimi, informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet, broshura të ndryshme promovuese të TBU publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare të kostove sipas njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit por harton një raport financiar në nivel institucioni dhe për periudha vjetore që përkojnë me vitin financiar, i cili fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor (Pasqyrat Financiare të TBU sh.p.k.).</p> <p>Sipas parashikimeve në Statutin e TBU (<i>nenet 10 & 11</i>), Administratori i TBU harton projekt buxhetin vjetor mbi propozimet e njësisë kryesore dhe të njësisë bazë në mbështetje të planit strategjik të zhvillimit të institucionit dhe planin buxhetor afatmesëm të tij. Këto dokumenta më pas miratohen nga Bordi i Administrimit i TBU, që mbikëqyr edhe zbatimin e tyre.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 2. Statuti TBU.pdf; 53.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2).pdf; 53.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023.pdf; vizita në institucion;</p>

<p>Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të RVB, GVJ konstaton se Zyra e Financës, strukturë në varësi të Administratorit të TBU, harton raportin vjetor financiar (Pasqyrat Financiare të TBU sh.p.k.) dhe bën një parashikim të të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara sipas njësisë kryesore (projekt buxheti 3 vjecar). Këto dokumenta më pas miratohen nga Senati dhe Bordi i Administrimit i TBU.</p> <p>Në këto raporte financiare të ardhurat janë të klasifikuara sipas burimeve kryesore të financimit të TBU: nga aktiviteti kryesor (tarifat e studentëve) dhe nga aktivitete të tjera në përputhje me objektin e aktivitetit të shoqërisë tregtare TBU sh.p.k. Gjithashtu, shpenzimet janë të klasifikuara sipas natyrës së tyre: në shpenzime për personelin, shpenzime operative, shpenzime për amortizimin dhe shpenzime financiare.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 53.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2).pdf; 53.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023.pdf; 55. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27.pdf;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni jo publik i arsimit të lartë Tirana Business University është i themeluar si shoqëri tregtare me përgjegjësi ligjore të kufizuar, për pasojë aktiviteti tregtar rregullohet edhe nga Ligji Nr.9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, i ndryshuar. Shoqëria ka detyrim ligjor përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Ligjin Nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“ si dhe publikimin e tyre pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).</p> <p>Kuadri rregullator i TBU (neni 54 i Statutit) parashikon kontrollin dhe auditimin e brendshëm të aktivitetit financiar të institucionit nga njësi e auditimit të brendshëm, që ngrihet dhe funksionon me vendim të Bordit të Administrimit të TBU. Bazuar në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ konstaton se gjatë viteve 2021, 2022, 2023 pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare TBU sh.p.k. i janë nënshtruar auditimit të jashtëm nga shoqëritë audituese Kreston Albania sh.p.k. dhe</p>

	<p>Nexia AL sh.p.k. Për secilin prej këtyre viteve, audituesi i jashtëm shprehet (opinion) se pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare TBU sh.p.k paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar, performacën financiare dhe flukset monetare të saj, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.</p> <p><i>Referenca:</i> 2. Statuti TBU.pdf; 53.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023.pdf; 54. Raport auditimi 2021_2022_2023.pdf;</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare në mbyllje të një cikli të plotë studimi, por në nivel institucioni. Sipas parashikimeve në kuadrin rregullator të TBU, pasqyrat financiare të përgatitura nga Administratori dhe Zyra e Financës e TBU, marrin miratimin nga Senati dhe Bordi i Administrimit i TBU në një mbledhje të hapur, të përbashkët ku marrin pjesë dhe përfaqësues nga personeli akademik, administrative dhe studentët.</p> <p>Bazuar në informacionin e këtyre pasqyrave Administratori dhe Zyra e Financës e TBU hartojnë një relacion përmbledhës për realizimin e buxhetit mbi baza vjetore dhe parashikimi për vitin në vijim, i cili bëhet pjesë e analizave deri në nivel departamenti për një analizë krahasuese të realizimit të objektivave financiarë.</p> <p><i>Bazuar në dokumentin e paraqitur, GVJ vlerëson se kjo analizë është në nivele modeste prandaj rekomandon hartimin e raporteve financiare të dedikuara në nivel programi studimi për një analizë më të plotë dhe domethënëse në funksion të optimizimit të burimeve për realizimin e programeve të studimit pranë TBU.</i></p> <p><i>Referenca:</i> TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 53.1. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1).pdf; 53.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023.pdf; 55. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27.pdf; 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ konstaton se institucioni në</p>

<p>programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>tre vitet financiare të fundit (2021-2023) rezulton fitimprurës dhe me opinion të konfirmuar nga audituesi i jashtëm.</p> <p>Sipas Statutit të TBU (neni 10) Bordi i Administrimit garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe përbushjen e misionit të tij. Që prej vitit 2023, Grupi Balfin ka shtuar ndikimin dhe kontributin financiar në TBU. Gjithashtu në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2024-2029 të TBU, qëndrueshmëria financiare përcaktohet si një nga drejtimet strategjike për stabilitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të institucionit.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 2. Statuti TBU.pdf; 53.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2).pdf; 53.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023.pdf; 54. Raport auditimi 2021_2022_2023.pdf; 55. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27.pdf; vizita në institucion;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se TBU harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel institucioni, por nuk bën analiza financiare në nivel njësie kryesore/ bazë apo sipas programeve të studimit.</i></p> <p><i>Gjithashtu, pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare TBU sh.p.k auditohen nga audituesi i jashtëm dhe përmes strukturës së re të pronësisë, Grupit Balfin, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHËTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>TBU ka ngritur të gjithë veprimtarinë e saj akademike dhe administrative duke patur në qendër studentin. Politikat dhe procedurat e universitetit, të bazuara në ligj dhe në filozofinë e tij, mbështesin studentin që nga momenti kur aplikanti/kandidati potencial kërkon të informohet, më pas kur bëhet student, kalon vitet e studimit dhe diplomohet e vijon si alumni.</p> <p>Për të gjitha procedurat e regjistrimit në MPABA, krahas pjesës ligjore të përcaktuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, VKM për regjistrimin në U-Albania dhe udhëzime e akte të tjera nënligjore, TBU përkujdeset që aplikanti- student të mbështetet dhe me informacion të plotë mbi programin e studimit që preferon. BU ka sanksionuar në rregulloret e tij në nivel universiteti, fakulteti, departamenti dhe programi studimi një sërë rregullash dhe procedurash që shoqërojnë studentin nga momenti që vendos të aplikojë për programin MPABA deri në diplomimin e tij.</p> <p><i>Referenca:</i> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf; 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë.pdf; 7. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD).pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rregulloret në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë si dhe modalitetet e organizimit dhe funksionimit të Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së Çështjeve Studentore, bëjnë të mundur garantimin e barazisë në hyrje dhe në trajtim të studentëve gjatë periudhës së studimeve deri në diplomim.</p> <p><i>Referenca:</i> 5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf; 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë.pdf; 7. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD).pdf;</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p><i>9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</i></p> <p>Hyrja e studentëve në programin e studimit MPABA bëhet bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe në të gjitha udhëzimet që në mënyrë periodike dalin nga MAS për regjistrimet në universitet</p> <p>Zyra e Çështjeve Studentore dhe stafi akademik i Departamentit në përputhje me Rregulloren e Institucionit, luajnë një rol shumë të rëndësishëm për këshillimin e studentëve në sistem (atyre që studiojnë BA në TBU) dhe të aplikantëve të tjerë. Në Rregulloren e TBU, definohen procedurat e rekrutimit të studentëve.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf;</i> <i>9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në lidhje me kriteret e pranimit në programin MP në Administrim Biznesi i Avancuar, TBU zbaton Ligjin 80/2015 dhe udhëzimet që MAS nxjerr çdo vit për regjistrimet në universitet.</p> <p>Dokumentat të cilat dorëzohen nga studentët janë në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë, udhëzimet e MAS dhe Rregulloren e TBU në lidhje me regjistrimin e studentëve në programin MP. Përsa i përket tranferimeve, zbatohet Ligji 80/2015 dhe udhëzimet që MAS nxjerr çdo vit akademik në prag të regjistrimeve. Transferimi bëhet i mundur përmes një procedure të caktuar,</p> <p><i>Referenca:</i> <i>5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf;</i> <i>9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>TBU informon të gjithë të interesuarit për kriteret e pranimit dhe regjistrimit në universitet, përmes faqes në internet, broshurave, reklamave, panairove të ndryshme, ditëve të hapura, medias sociale, dhe stafit të Zyrës së Çështjeve Studentore, stafit akademik, etj.</p> <p>Aktualisht, TBU ofron bursa ekselence dhe bursa sociale. Përfaqësuesit e Zyrës së Çështjeve Studentore gjatë këshillimit të kandidatëve qartësojnë edhe kriteret për bursa ekselence të</p>

	<p>plota dhe të pjeshme. Gjithashtu, në vitin e fundit akademik, TBU ka dhënë dhe bursë sociale. Departamenti, si rregull, propozon çdo vit kuotat dhe kriteret e pranimit, bazuar në kriteret ligjore, kapacitetet njerëzore dhe ato infrastrukturore dhe më pas ato miratohen në Senat. Duhet thënë që në lidhje me këtë program studimi nuk ka kritere shtesë, përpos atyre ligjore për t'u pranuar apo për të transferuar studimet.</p> <p><i>Referenca:</i> 5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Duhet thënë që në lidhje me këtë program studimi nuk ka kritere shtesë, përpos atyre ligjore për t'u pranuar apo për të transferuar studimet. Bursat dhe format e ndryshme të ndihmës financiare publikohen çdo vit në faqen e internetit të TBU. Përmes një sërë dokumentash të vendosura në platformen e Ascal vlerësojmë qasjen pozitive të kolegjit universitar në mbështetje të edukimit të studentëve.</p> <p><i>Referenca:</i> 5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, duhet thënë që institucioni respekton aspektet ligjore të cilat përcillen vit pas vit nga MAS në lidhje me pranimin e kandidatëve që vijnë nga vendet fqinjë shqipfolëse dhe më gjerë, individët me aftësi të veçanta dhe individë që vijnë nga shtresat e marxhinalizuara</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Përmes RVB dhe vizitës në institucion, GVJ evidentoi që TBU ka dhënë bursa ekselence, për studentët me mesatare shumë të lartë, por dhe me arritje të tjera në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Bursat dhe format e ndryshme të ndihmës financiare publikohen çdo vit në faqen e internetit të TBU. Përmes një sërë dokumentash të vendosura në platformen e Ascal vlerësojmë qasjen pozitive të kolegjit universitar në mbështetje të edukimit të studentëve.</p>
	<p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</p>

	<p>79.1. <i>Vendim për tarifën dhe bursat e studentëve për vitin 23-24.pdf;</i> 79.2. <i>Tarifën dhe bursat VA 2024-2025.pdf;</i> 79.3. <i>Të dhëna për shpërndarjen e bursave ndër vite.pdf;</i> 79.4. & 79.5 <i>Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23.pdf;</i> 79.6. <i>Skema e bursave sociale në TBU.pdf;</i> <i>vizita në institucion;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson që në lidhje me këtë standard, TBUka ngritur e ndjekur të gjitha procedurat në përputhje me ligjin dhe udhëzimet e VKM që burojnë prej tij, në lidhje me pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. <u>Sugjerojmë</u> veprimin më proaktiv ndaj strategjive të ndërkombëtarizmit edhe përmes studentëve të huaj.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Biznes i Avancuar”, me 120 kredite dhe me tre profile, informohen mbi tërësinë e rregullave dhe të procedurave të avancimit të tyre akademik në “Ditët e Hapura” që organizohen në nisje të vitit akademik (veçanërisht për studentët e vitit të parë), bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Natyrisht, çdo pedagog në javën e parë të zhvillimit të lëndës qartëson elementët e vlerësimit me komponentët e saj, literaturën, detyrimin e frekuentimit, etj. Brenda TBU funksionon këshillimi akademik për studentët në të gjithë rrugëtimin e tyre dy vjeçar në këtë program studimi.</p>
	<p><i>Referenca:</i> 01. <i>TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</i> <i>vizita në institucion;</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në Rregulloren e TBU, në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë; në Rregulloren e Programit të Studimit paraqiten në mënyrë të hollësishme procedurat e përparimit akademik.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i Studimeve që përmban: organizimin e mësimdhënies; frekuentimin, organizimin e procesit të përgatitjes së punimit të diplomës, etj; - Kontrolli i dijes dhe vlerësimi përmban format e vlerësimit të dijës, afatet e provimeve, kushtet e hyrjes në provim, ankimimin, riprovimin për mirësimin dhe mbartjen. -procedurat e transferimit, njohjes dhe njehsimit të periudhave të studimit; - fitimi, pezullimi dhe përfundimi i statutit të studentit; <p><i>Referenca:</i> 5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf; 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë.pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; 33. Rregullore e Transferimeve në TBU.pdf;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Elementët e vlerësimit të vazhduar të studentëve qartësohen në silabusin e çdo lëndë dhe përbëhen nga vlerësimi për angazhimin në seminare/detyra e kursit/provimi i ndërmjetëm dhe përfundimtar. Këto rregulla janë pjesë e Rregullores së TBU, Rregullores së Programit të Studimit. Për studentët këto rregullore janë të aksesueshme në faqen e internetit të universitetit. Informimi i studentëve për procedurat e përparimit akademik bëhet përmes disa formave: në klasë në ditët e informimit; në sistemin e brendshëm LMS, si dhe në vijimësi nga çdo pedagog në mësim në përputhje me syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>Referenca:</i> 5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf;</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me</p>	<p>Në detyrimet përmbyllëse të programit të studimit MPABA është provimi i përgjithshëm/punimi i diplomës. Studentët</p>




<p>kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>mund të zgjedhin në funksion të mesatares që kanë në studimet master, apo të lirisë së tyre në vendimarrje.</p> <p>Në Rregulloren e TBU dhe të programit të studimit përcaktohet procedura e realizimit të punimit të Diplomës dhe sezonet që studenti mund ta mbrojë atë. Ndërsa në Udhëzuesin për përgatitjen e temës së Diplomës jepet procedura e hartimit dhe modeli i punimit të diplomës. Gjatë vizitës në institucion, takimeve me stafin e departamentit të Biznesit dhe Financës, takimeve me sekretarinë mësimore dhe studentët që ndjekin MBAB, vlerësuam që përgjithësisht rregulloret, procedurat dhe sistemet funksionojnë në plotësimin e veprimtarive mësimore të studentëve.</p> <p><i>Referenca:</i> 5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; 10. Format i tezës së provimit përfundimtar.pdf; 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës (me anekse).pdf;</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>TBU ndjek disa rrugë për informimin e kandidatëve për studentë për vitin e ardhshëm akademik, të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra për Çështjet Studentore është gjatë gjithë vitit në funksion të informimit të çdo personi të interesuar për të studjuar në TBU apo familjari të tij; - Zyra për Çështjet Studentore përgatit një plan vjetor aktiviteteve të cilat i zbaton në bashkëpunim me zyrat e tjera në suport të studentit dhe Departamentit të Biznesit dhe Financës; - Ditët e Hapura të zhvilluara në institucion; - pjesëmarrja në panairët e organizuara nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në qytetet kryesore të Shqipërisë; - botimet e fletëpalojeve, broshurave, spoteve në TV dhe publikimet në faqen e TBU dhe në median sociale; <p><i>Referenca:</i> 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore.pdf; 14.5. Ditët informuese në TBU.pdf; 52. Politika e Marketingut të TBU për programet e studimit.pdf;</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ në lidhje me këtë standard vlerëson se TBU mban të informuar studentët për përparimin akademik, diplomimin e</p>

	<i>tyre dhe nga pikëpamja procedurale dhe e aksesit ka ngritur sistemin e duhur në funksion të informimit të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.

TBU ka ngritur sistemin e plotë për informimin e studentëve dhe të të interesuarve për studentë dhe të familjarëve të tyre për programet e studimit, organizimin dhe rregullat bazë të funksionimit, si dhe të gjithë mundësinë që institucioni krijon për karrierën e tyre.

Studentët aktualë dhe të ardhshëm informohen përmes disa mundësive:

- Faqja zyrtare e TBU në internet (<https://tbu.edu.al/en/home-en/>);
- Zyrës për Çështjet Studentore;
- Materialeve promovuese broshura, fletëpalosje, etj;
- Ditëve të hapura – ku roli i Departamentit në qartësimin e strukturës së programit është shumë i rëndësishëm, por dhe zyrat administrative, përfshirë Sekretarinë Mësimore luajnë një rol rëndësishëm në plotësimin e të gjithë elementëve që student ka interes. Gjithashtu, qartësohen dhe të gjitha zyrat e tjera të cilat janë në shërbim të studentit, financa, IT, etj;
- Këshilluesit akademik – shoqëron dhe suporton studentin gjatë gjithë periudhës së studimit, për çështje të natyrave të ndryshme që e shoqërojnë;
- Javën e parë të mësimit nga çdo pedagog, i cili qartëson të gjithë elementët e silabusit;
- Medias sociale të TBU-së;
- Email zyrtar të studentit në TBU, me të cilin pajiset në momentin e regjistrimit dhe të nëshkrimit të kontratës;

	<p><i>Referenca:</i> 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore.pdf; 14.5. Ditët informuese në TBU.pdf; 52. Politika e Marketingut të TBU për programet e studimit.pdf;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Kandidatët për studentë dhe studentët e regjistruar kanë mundësinë të marrin informacionin për programin përmes faqes zyrtare të TBU në internet, medias sociale, materialeve promovuese broshura, fletëpalosje, të cilat gjenden në Zyrën e Çështjeve Studentore dhe që përdoren dhe nga këshilluesit akademikë të çdo departamenti, Ditëve të hapura – të cilat organizohen si nga TBU ashtu dhe nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me MAS dhe Zyrat Vendore Arsimore. Shumë e rëndësishme është dhënia e informacionit mbi rregulloret e ndryshme gjatë javës së parë të vitit akademik si nga drejtuesit akademike ashtu dhe nga ata administrative. Gjithashtu në javën e parë të mësimit nga çdo pedagog, i cili qartëson të gjithë elementët e silabusit, rregullat e frekuentimit, modalitetet e vlerësimit. Në funksion të gjithë këtij procesi është dhe sistemi Pitagora dhe LMS.</p> <p><i>Referenca:</i> 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore.pdf; 14.5. Ditët informuese në TBU.pdf;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë vizitës në TBU dhe takimit me studentët, GVJ evidentoi dy elementë në lidhje me këtë kriter:</p> <ul style="list-style-type: none"> - së pari, të gjithë studentët punonin; - së dyti, studentët u shprehën që në inbox e email të tyre vinin me një frekuencë shumë të lartë, njoftime për mundësi punësimi. <p><i>Vlen të ritheksohet që sinergjia me Grupin Balfin është një avantazh i jashtëzakonshëm për studentët e TBU dhe natyrisht dhe të programit të studimit Master Profesional Administrim Biznes i Avancuar me profile</i></p>




<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>TBU, si një IAL jopublike, dëshmon një angazhim të lartë në informimin e studentëve përmes të gjitha zyrave dhe njësisive dhe një qasje proaktive në përdorimin e sistemeve të brendshme të informacionit. Në momentin që studenti regjistrohet pajiset me email e tij dhe kjo e bën pjesë të LMS, Pitagorës dhe të gjithë bazës së email të Zyrës së Çështjeve Mësimore dhe Departamentit e Fakultetit.</p> <p><i>Referenca:</i> 12.1. Kalendari Akademik 21-22.pdf; 12.2. Kalendari Akademik 22-23.pdf; 12.3. Kalendari Akademik 23-24.pdf; 51.2. Guidë për studentët për përdorimin e LMS.pdf; 51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.pdf;</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Studentët u shprehën gjatë takimit se ata informohen në lidhje me çdo fazë të procesit mësimor, aktivitete kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, mundësi për punësime, trajnime, etj</p> <p><i>Referenca:</i> 12.1. Kalendari Akademik 21-22.pdf; 12.2. Kalendari Akademik 22-23.pdf; 12.3. Kalendari Akademik 23-24.pdf; 51.2. Guidë për studentët për përdorimin e LMS.pdf; 51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.pdf;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që aktualisht TBU ofron informacion të plotë mbi strukturën, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</i></p> <p><i>Sistemet e Menaxhimit të Informacionit, si LMS, Pitagora dhe mediat sociale i shërbejnë më së miri ndërveprimit dhe informimit të studentëve</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.

TBU mban dhe përpunon një sërë statistikash që lidhen nga njëra anë me detyrimin ligjor, nga ana tjetër janë të rëndësishme për menaxhimin e të gjithë veprimtarisë së universitetit, ndërtimit të strategjive të ardhshme, ndërhyrjet korrigjuese në sistem dhe vlerësimin e performancës së programeve, departamenteve dhe zyrave. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, në aktet ligjore dhe nënligjore, Rregulloren e TBU, është hartuar Rregullorja e Sekretarisë Mësimore, që në setin e dokumentave të vendosura në platformën e ASCAL vjen si rregullore për krijimin, regjistrimin, ruajtjen dhe dorëzimin e dokumentave në TBU.

Referenca:

5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf;

8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore.pdf;

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 4 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon:

Profili Manaxhim:

Viti akademik	Të regjistruar	Çregjistrime	Të diplomuar
2021-2022	6 studentë	5 studentë	3 studentë
2022-2023	9 studentë	2 studentë	Asnjë
2023-2024	3 studentë	-	7 studentë
2024-2025	1 studentë	-	në proces

Profili Kontabilitet Finance:

Viti akademik	Të regjistruar	Çregjistrime	Të diplomuar
2021-2022	9 studentë	2 studentë	3 studentë
2022-2023	11 studentë	2 studentë	4 studentë
2023-2024	4 studentë	-	8 studentë
2024-2025	1 studentë	-	në proces

Profili e Drejte Biznesi:			
Viti akademik	Të regjistruar	Çregjistrime	Të diplomuar
2021-2022	6 studentë	4 studentë	4 studentë
2022-2023	7 studentë	-	3 studentë
2023-2024	9 studentë	4 studentë	9 studentë
2024-2025	3 studentë	-	në proces

Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matricullimi. Gjithashtu, gjatë vizitës, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit “Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar” dhe konstatoi plotësinë e tyre.

Referenca:
01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;
5... Rregullore e Kolegjit Universitar “TBU”...pdf;
8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore.pdf;
vizita në institucion;

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e jashtëm kaluan një kohë dhe në Sekretarinë Mësimore. Dosjet e ecurisë së studentëve nga semestri në semestër dhe për çdo vit akademik, regjistri themeltar dhe çdo informacion tjetër që iu kërkua stafit u vendos në dispozicion. Gjithashtu, shqyrtuam dhe mbajtjen e të gjithë informacionit në mënyrë elektronike përmes sistemit Pitagora.

Referenca:
01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;
5... Rregullore e Kolegjit Universitar “TBU”...pdf;
8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore.pdf; vizita në institucion;

Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe

Në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, Sekretaria Mësimore si pjesë e Administratës të TBU, ka ndërtuar gjithë sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit për studentët që nga momenti i regjistrimit në përputhje me rregullat e MAS, deri në përfundim të studimeve dhe pajisjen me diplomë dhe suplementin e diplomës.

Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, dosjet fizike dhe “dosjet elektronike”, regjistrat, proces-verbalet, regjistri themeltar dhe

dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	çdo dokument tjetër që është nën përgjegjësinë e zyrës ishin lehtësisht të verifikueshme dhe mjaft mirë të sistemuara. <i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf; 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore.pdf; vizita në institucion;			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	TBU, bazuar në udhëzimet e MAS harton raportet vjetore, me një format standard dhe një nga rubrikat i referohet të dhënave të studentëve për çdo program studimi. Një Raport tjetër i rëndësishëm është dhe analiza vjetore e punës së departamentit. <u>Statistikat mbi tregues të ndryshëm për studentët do të duhet të pasurohen dhe dokumentohen, me qëllim që të ngrihen analiza mbi to. Gjithashtu, nevojitet të ketë auditime periodike të Sekretarisë Mësimore dhe mbi këtë bazë të përpilohen raporte.</u> <i>Referenca:</i> 31. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin (Aneks Tabela 21).pdf; 70.1. Raporti vjetor I DBF 23-24.pdf; 71.1. Raporti vjetor institucional 2021-2022.pdf; 71.2. Raporti vjetor institucional 2021-2022.pdf; 71.3. Raporti vjetor institucional 2023-2024.pdf;			
Konkluzione	GVJ vlerëson, që në lidhje me këtë standard, TBU mbledh, përpunon të dhënat dhe ndërton raporte të cilat i shërbejnë përmirësimit të vazhdueshëm të menaxhimit të universitetit, por nevojitet të ndërtojë dhe raportet e auditimit të zyrave që punojnë në këtë aspekt.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe

Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë Nr.80/2015, në aktet nënligjore, si dhe në Statutin dhe në disa rregullore

<p>angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>institucionale studentët përfshihen në një sërë organesh me karakter vendimarrës, këshillues dhe procedural si më poshtë paraqitet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik; - Komisioni për Marrëdhëniet me Studentët në nivel institucional; - Komisioni për Marrëdhëniet me Studentët në nivel fakulteti; - Komisioni i sigurimit të cilësisë në nivel institucional; - Komisioni i sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti; - Grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë. <p>Gjatë takimit në institucion me studentët, vlerësuam se raportet e tyre me TBU, Departamentin dhe Zyrat janë frutdhënëse. Duket që numri i vogël i studentëve e bën më të lehtë dhe efikas komunikimin dhe bashkëpunimin mes tyre, si dhe më të thjeshtë angazhimin e studentëve.</p> <p><i>Referenca:</i> 2. Statuti TBU.pdf; 72. Përfshirja e studenteve ne qeversijen e TBU.pdf;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Ligji për Arsimin e Lartë Nr 80/2015 përcakton të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në një sërë organesh vendimmarrëse dhe me rol konsultativ brenda strukturave të universitetit. Në Statutin e TBU dhe në Rregulloren e tij, nene të caktuara i dedikohen të drejtës së studentëve të përfaqësohen në organet e TBU, me përjashtim të rastit kur ligji e përcakton ndryshe. Përpos pjesëmarrjes në Senat dhe në Komisionet e Sigurimit të Cilësisë, një veprimtari e rëndësishme e sanksionuar me Statut janë Komisionet për Marrëdhëniet me Studentët të cilat mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat e studentëve në të gjitha programet e studimit.</p> <p><i>Referenca:</i> 2. Statuti TBU.pdf; 72. Përfshirja e studenteve ne qeversijen e TBU.pdf;</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe</p>	<p>Mbështetur në Statut, në disa nga rregulloret sanksionohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimmarrje. Studentët përfshihen në mënyrë direkte dhe</p>

<p>përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>indirekte në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor dhe programit të studimit.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në disa komisione, në Senat, në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimit të programeve, MPABA, me 120 ECTS dhe 3 profile.</p> <p>Gjithashtu, ata bëjnë vlerësimin periodik të mësimdhënies së pedagogëve, ndërveprojnë gjatë gjithë periudhës së studimeve me drejtuesit e departamentit dhe fakultetit, ndërveprojnë dhe orientojnë pakënaqësitë apo sugjerimet e tyre në Zyrën për Çështjet Studentore, ndërveprojnë me pedagogun këshillues dhe natyrisht sjellin zërin e tyre përmes Komisionit për Marrëdhëniet me Studentët. Institucioni po bën përpjekje për të krijuar një traditë me fokus grupet, mbledhjet periodike me studentët, dhe mbështetjes për hapat më tej të karrierës së studentëve.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 2. Statuti TBU.pdf; 36.7. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetësorit nga studentet.pdf; 36.9. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët.pdf; 36.10. Raporti i Fokus Grupeve.pdf; 72. Përshirja e studentëve në qeverisjen e TBU.pdf;</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët kanë të drejtë të kërkojnë shpjegim për mënyrën e vlerësimit të dijeve në të gjitha format e kontrollit të dijeve, nga pedagogu i tyre. Në rastin kur shpjegimi i pedagogut nuk është shterues për arsyet që studenti mbron, ai gëzon të drejtën e ankimimit në departament ku bazuar në një procedurë drejtuesi i tij ngre një komision ad-hoc vlerësimi, i cili detyrimisht në fund të këtij procesi duhet të marrë një vendim rishikimi apo refuzimi.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf; 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore.pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf;</p>

Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson që në lidhje me këtë standard, TBU respekton aspektet ligjore dhe të rregulloreve që burojnë mbi këtë bazë për përfshirjen e studentëve në një sërë organesh vendimore dhe këshilluese.</i></p> <p><i>Gjithashtu, nën moton studenti në qendër dhe cilësia në funksion të tij, kanë ndërtuar mekanizmat e duhura për përmirësimin e procesit mësimor dhe programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrjnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin dhe Rregulloret intitucionale në nivel universiteti dhe fakulteti, në shërbim të informimit të studentit dhe të përparimit të tij në sistem nga momenti që kërkon informacion mbi programin, deri në diplomimin e tij, janë një sërë zyrash në rang kolegji universitar.</p> <p>Zyra për Çështjet Studentore shërben si hallka e parë e komunikimit të një të interesuari për programet e studimit në TBU, duke dhënë të gjitha informacionet që nga programet, tarifat e studimit, jeta studentore, rregullat e brendshme, kalimi nga një vit në një tjetër, etj. Gjatë vizitës në institucion evidentuam nga komunikimi me studentët dhe përfaqësuesit e Zyrës që krahas funksioneve të cituara më lart, ajo lehtëson gjithë ndërveprimin e studentëve me pjesën akademike dhe administrative të universitetit duke suportuar studentin gjatë gjithë ciklit të studimeve.</p>
	<p><i>Referenca:</i> <i>01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf;</i> <i>14.3. Aktivitete të realizuara nga zyra për studentët.pdf;</i> <i>vizita në institucion;</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bër funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>TBU ka ngritur strukturën e këshilluesve akademikë për çdo departament, si një hallkë ndërlidhëse e studentit me të gjitha proceset që institucioni krijon për ta lehtësuar avancimin e tij në sistem, por dhe për ta suportuar në karrierë. Gjithashtu, këshilluesi akademik ndihmon në zgjidhjen e problematikave që studenti ndesh në sistemin akademik apo administrativ, në përputhje me rregulloret e brendshme të institucionit.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 14.7. Rrregullore e Këshillimit Akademik.pdf; 14.8. . Plan Pune Këshilltari Akademik FBD.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë takimit të ekspertëve në TBU me studentët, evidentuan që studentët u shprehën shumë pozitivë për eksperiencën e tyre në programin MPABA, ndonëse dukeshin pak konfuzë për kompetencat që programi ofron dhe për perspektivën që ata kanë në tregun e punës.</p> <p>Për madhësinë që TBU ka, shërbimi i karrierës ofrohet nga Zyra për Çështjet Studentore dhe këshilluesit akademikë në departament. Zyra është shumë proaktive për të lidhur studentët me tregun e punës, mundësuar kjo përmes organizimit të shumë eventeve me të ftuar, Panairit të Punës, Konkurseve, vizitave në biznes, etj. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim kanë dhe Bordet e Punës, njësi ad hoc që bashkëveprojnë me departamentin në disa drejtime, nga kurrikula, praktikat, të ftuarit në auditor e deri në karrierën e studentëve.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore.pdf; 14.1. Vendim dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD.pdf; 14.1.1. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës.pdf; 14.2. Panairi i punës 2024 (ftese).pdf; 14.3. Aktivitete të realizuara nga zyra për studentët.pdf; 14.7. Rrregullore e Këshillimit Akademik.pdf; 14.8. . Plan Pune Këshilltari Akademik FBD.pdf;</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna</p>	<p>Dinamikat e brendshme institucionale kanë hapur disa drejtime të rëndësishme të punës në IAL. Në kohë, institucioni do të duhet të rrisë dhe numrin e stafit administrativ, në mënyrë që të përpunojë të dhëna të tjera në përputhje me standardet dhe të</p>

<p>mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>lehtësojë stafin akademik nga detyrimet administrative. Dinamikat e rritjes duhet theksuar që janë pozitive dhe përmirësimi i proceseve të brendshme natyrisht do të kërkojë kohën e vet.</p> <p><u>Gjatë vizitës në institucion, bisedës me përfaqësuesit e zyrave që punojnë me studentët dhe vetë studentët, evidentuam disa elementë që mendojmë se duhen patur në konsideratë nga TBU:</u></p> <p><u>- Duhet të punohet për një përkatësi dhe krenari të studentit me emrin e TBU dhe kjo kërkon një filozofi dhe strategji;</u></p> <p><u>- Panairi i Punës është një event që kërkon feedback, nga studentët, nga bizneset, output të qartë, përndryshe është vetëm një event PR;</u></p> <p><u>- Më shumë proaktivitet në lidhje me rrjetin alumni</u></p> <p><u>- Duhet të punohet për më shumë mobilitete të studentëve të këtij programi studimi dhe për një listë MoU që pasurohet vazhdimisht me universitete të reja;</u></p> <p><u>- Më shumë proaktivitet në projekte lokale dhe ndërkombëtare, për rrjedhojë dhe në përfshirjen e studentëve në to.</u></p> <p>Referenca: vizita në institucion;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson që nga pikëpamja procedurale elementët ekzistojnë, por nga pikëpamja strategjike dhe e përmbajtjes duhet një qasje më aktive, më vizionare dhe më shumë përpjekje në forcim të brandit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</p> <p>Në takimet me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi gjatë vizitës në institucion, ata konfirmuan përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies në përputhje me parashikimet në syllabuset e lëndëve dhe me praktikat më të mira bashkëkohore si prezantime me powerpoint, prezantimi i rasteve studimore, prezantimi i videove ilustruese, ndarja në grupe pune, diskutimet e lira etj. Gjithashtu, ata konfirmuan disponimin e udhëzuesve për përdorimin e sistemeve IT të TBU, platformës TBU LMS për studentët dhe për pedagogët. Në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2024-2029 të TBU, mësimdhënia cilësore, me standarde evropiane dhe në përmirësim të vazhdueshëm shihet si një nga drejtimet kryesore strategjike të zhvillimit me studentin në qendër të veprimtarisë, si dhe duke integruar përdorimin e metodave, materialeve, teknologjive dhe eksperiencat bashkëkohore në këtë proces.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 3.1. TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.pdf; 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MPAB120 (shqip & anglisht).pdf; 45. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit (deri në Dhjetor 23).pdf; 51.1. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS.pdf; 51.2. Guidë për studentët për përdorimin e LMS.pdf; 51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.pdf; vizita në institucion;</p>

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

GVJ konstatoi se monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga bashkëpunimi mes strukturave si:

- Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC);
- Komisioni i Përhershëm i Cilësisë në nivel Fakulteti (KC);
- Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për programin e studimit;

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) e zhvillon aktivitetin në përputhje me rregulloren përkatëse dhe në bashkëpunim me strukturat e mësipërme ndjek të gjitha problemet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në TBU me fokus procedurat, politikat dhe aktivitetet e lidhura me cilësinë, si dhe dokumentacionin përkatës në nivel institucioni. NJBSC përbëhet nga tre anëtarë që emërohen nga Senati dhe raporton tek Rektori i TBU (Neni 27 i Statutit dhe neni 21 i Rregullores së NJBSC).

Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e strukturuar për vlerësimin anonim nga studentët të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave pedagogjike të përdorura. Gjithashtu, përdoren edhe analizat e përvojës studentore përmes fokus grupeve, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe TBU (analizat vjetore përkatëse). Në nivel departamenti mekanizmat e vlerësimit përfshijnë edhe vlerësimin/ndjekjen e procesit të mësimor nga drejtuesi i departamentit ose pedagogë me eksperiencë etj.

Komisioni i Përhershëm i Cilësisë në nivel Fakulteti (KC) e zhvillon aktivitetin në përputhje me parashikimet në kuadrin rregullator të TBU (Statuti, neni 28 dhe Rregulloren e Organeve Kolegjiale të TBU) dhe ka për detyrë garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe të programit të studimit. GVJ konstatoi se Statuti i TBU parashikon edhe ngritjen e Komisionit të Përhershëm të Cilësisë në nivel institucioni dhe të Zyrës së Kurrikulave, por nuk konstatoi ndonjë dokument lidhur me veprimtarinë apo kontributin e realizuar prej tyre në nivel TBU.

GVJ rekomandon që institucioni duhet të qartësojë emërtimet dhe ndarjen e detyrave mes këtyre strukturave, me qëllim evidentimin e qartë të veprimtarisë dhe kontributit të secilit në funksion të sigurimit të cilësisë.

Referenca:

	<p>01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 2. Statuti TBU.pdf; 15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU.pdf; 20. Rregullore për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale.pdf; 36.1. Rregullore NJSBC.pdf; 36.7. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet.pdf; 36.8. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve.pdf; 36.9. Formati i pyetesorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët.pdf; 76. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ vlerëson se kadri rregullator i TBU u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj. Përmes pyetësorëve gjysëm të strukturuar të realizuar nga NJBSC, në nivel institucioni. Gjithashtu, Rregullorja e TBU (neni 28) dhe Rregullorja e FBD (neni 29) parashikojnë të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me rezultatin e kontrollit të dijeve, kundrejt një kërkesë me shkrim që i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit përkatës sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara.</p> <p><i>Referenca:</i> 5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf; 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise.pdf; 36.7. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet.pdf; 36.8. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve.pdf; 36.9. Formati i pyetesorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se NJBSC dhe KC hartojnë raporte (mbi pyetësorët e studentëve, zhvillimin e mësimin, ecurinë e akreditimit etj) që u paraqiten strukturave drejtuese të institucionit dhe përmes tyre informohet në mënyrë konfidenciale edhe personeli akademik me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Gjithashtu, këto raporte bëhen pjesë edhe e analizave vjetore që realizohen në nivel departamenti dhe fakulteti.</p> <p><i>Referenca:</i></p>

	<p>01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 36.10. Raporti i Fokus Grupeve.pdf; 36.5. Raporti vjetor i NJSBC 24-23.pdf; 36.6. Raporti vjetor i KC FBD 22-23.pdf; 41. Analiza e departamentit pergjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MP120.pdf; 70.1. Raporti vjetor i DBF 23-24.pdf; 71.3. Raporti vjetor institucional 2023-2024.pdf; vizita në institucion;</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në takimin e zhvilluar me drejtuesit e këtij programi studimi, gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e praktikave më të mira dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies përmes përdorimit të rezultateve të mekanizmave të vlerësimit si pyetësorët e studentëve, formulari i vlerësimit për pedagogun, formulari i vetëvlerësimit dhe indikatorët e performancës etj.</p> <p><i>Referenca:</i> 41. Analiza e departamentit pergjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MP120.pdf; 43.1.1. Indikatorët e vlerësimit të performancës kërkimore-shkencore për personelin akademik.pdf; 70.1. Raporti vjetor I DBF 23-24.pdf; 71.3. Raporti vjetor institucional 2023-2024.pdf; vizita në institucion;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i TBU u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankimim.</p> <p>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët gjysëm të strukturuar të studentëve në fund të çdo semestri, fokus grupet si dhe analizat vjetore të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe TBU.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, Statutit dhe Rregulloreve të TBU, GVJ konstatoi se procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Përgjegjësia institucionale e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë i takon Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) në bashkëpunim dhe me strukturat e tjera drejtuese të TBU. Në nivel Fakulteti është organizuar dhe funksionon Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë (KC) me anëtarë të përzgjedhur nga personeli akademik i TBU si dhe me përfaqësues nga Këshilli Studentor.</p> <p>Institucioni ka hartuar edhe dy dokumenta në shërbim të mirëfunksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë: “Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies” dhe “Politika e Zhvillimit të Kurrikulave”, që paraqesin standardet për sigurimin e cilësisë, parimet kryesore të zhvillimit të kurrikulave, procedurat për hapjen, riorganizimin e programeve të studimit, procedurat e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, të cilësisë së studentëve dhe të personelit akademik, vlerësimin e veprimtarisë kërkimore shkencore etj.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 2. Statuti TBU.pdf; 5... Rregullore e Kolegjit Universitar “TBU”...pdf; 15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU.pdf; 20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale.pdf; 36.1. Rregullore NJSBC.pdf; 36.2.Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25.pdf; 76. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.pdf;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe</p>	<p>GVJ konstatoi se Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) dhe Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë (KC) zhvillojnë veprimtarinë në përputhje me rregulloret përkatëse, në bazë të një plani vjetor pune të miratuar në fillim të vitit akademik dhe të dokumentuar në raportet vjetore dhe/ose periodike për strukturat drejtuese të TBU apo palë të tjera të interesuara.</p>

<p>bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2024-2029 të TBU, mësimdhënia cilësore, me standarde evropiane dhe në përmirësim të vazhdueshëm shihet si një nga drejtimet kryesore strategjike të zhvillimit me studentin në qendër të veprimtarisë, si dhe duke integruar përdorimin e metodave, materialeve, teknologjive dhe eksperiencat bashkëkohore në këtë proces.</p> <p>Në këtë dokument, bazuar në analizën SWOT të realizuar në ndihmë të planifikimit strategjik, identifikohen qartë synimet dhe objektivat, rezultatet e pritshme, si dhe hapat e veprimet e nevojshme për t'u ndërmarrë për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të TBU dhe të sistemit të sigurimit të cilësisë. Pjesë integrale e këtij zhvillimi është dhe angazhimi i studentëve, partnerëve, grupeve të interesit etj në procesin e përmirësimit të vijueshëm të cilësisë përmes veprimtarive ekstrakurrikulare, inkubatorëve të biznesit, krijimit të bordit të tregut të punës, rrjetit të sipërmarrjes etj.</p> <p><i>Referenca:</i> 3.1.. TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.pdf; 5... Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"...pdf; 14.1.1. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës.pdf; 14.1.2. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP.pdf; 15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU.pdf; 20. Rregullore për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale.pdf; 36.1. Rregullore NJSBC.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vitit 2021, TBU i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditimin institucional dhe të disa programeve të studimit në bazë të parashikimeve dhe përcaktimeve ligjore. Konkretisht, me vendimin Nr.21 të Bordit të Akreditimit, datë 12.03.2021 programi i studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar", me profile "Menaxhim", "Kontabilitet-Financë" dhe "E Drejtë Biznesi" dhe me 120 kredite, ka marrë akreditimin me kohëzgjatje 3 vite akademike. Vlefshmëria e këtij akreditimi ka përfunduar më 30.09.2024. Ndërsa, me vendimin Nr.56 të Bordit të Akreditimit, datë 16.12.2021 TBU ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 5 vite akademike. Vlefshmëria e këtij akreditimi përfundon më 15.12.2026.</p> <p><i>Referenca:</i></p>

	<p>68. Vendim BA-ASCAL nr. 42, dt. 12.03.2021 Akreditimi i programit Master Avancuar 120 me 3 profile.pdf; https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-12-mars-2021; vizita në institucion;</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e strukturuar për vlerësimin anonim nga studentët të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave pedagogjike të përdorura. Gjithashtu, përdoren edhe analizat e përvojës studentore përmes fokus grupeve, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti dhe TBU (në raportet vjetore përkatëse). Në nivel departamenti mekanizmat e vlerësimit përfshijnë edhe vlerësimin/ndjekjen e procesit të mësimor nga drejtuesi i departamentit ose pedagogë me eksperiencë etj.</p> <p>Në takimin e zhvilluar me drejtuesit e këtij programi studimi, gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e praktikave më të mira dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies përmes përdorimit të rezultateve të mekanizmave të vlerësimit si pyetësorët e studentëve, formulari i vlerësimit për pedagogun, formulari i vetëvlerësimit dhe indikatorët e performancës etj.</p> <p><i>Referenca:</i> 41. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MPI20.pdf; 43.1.1. Indikatorët e vlerësimit të performancës kërkimore-shkencore për personelin akademik.pdf; 70.1. Raporti vjetor I DBF 23-24.pdf; 71.3. Raporti vjetor institucional 2023-2024.pdf; vizita në institucion;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>TBU ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 5 vite akademike dhe programi i studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar me profile "Menaxhim", "Kontabilitet-Financë" dhe "E Drejtë Biznesi" po akreditohet për herë të dytë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i TBU parashikon në vija të përgjithshme procedura dhe mekanizma formalë për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë.</p> <p>Në mënyrë më specifike, Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi i Avancuar”, me 120 kredite dhe me 3 profile, parashikon vlerësimin çdo vit në përfundim të programit të studimit (neni 15) sipas procedurave të përcaktuara nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC).</p> <p>Në nivel institucioni NJBSC dhe Komisioni i Cilësisë (KC), hartojnë raporte specifike dhe vjetore lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor, procesin e akreditimit, aspektet formale të përgatitjes së programeve të rinj të studimit për të gjithë ciklet e studimit, si dhe rishikimin periodik të programeve ekzistuese që ofrohen në TBU. Këto raporte u paraqiten strukturave drejtuese të TBU dhe përmes tyre informohet edhe personeli akademik me synim përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Referenca:</i> 2. Statuti TBU.pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi i Avancuar” me 120 Kredite.pdf; 36.1. Rregullore NJSBC.pdf; 36.5. Raporti vjetor i NJSBC 24-23.pdf; 36.6. Raporti vjetor i KC FBD 22-23.pdf;</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në mbledhjen e Departamentit të Biznesit dhe Financës në fund të vitit akademik analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve. Ky informacion përfshihet në raportin e vjetor të analizës së veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të</p>

<p>dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>TBU sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës. Raporti vjetor i departamentit përmban informacion sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, personelin akademik dhe studentët, vlerësimin e kërkimit shkencor dhe të aktiviteteve të realizuara në funksion të detyrave si njësi bazë. Në anekset shoqëruese të raportit vjetor, paraqitet plani i aktiviteteve për t'u realizuar nga departamenti në vitin akademik pasues në funksion të realizimit të objektivave strategjike dhe të misionit të TBU. Gjithashtu, raportet vjetore të NJBSC dhe KC, në nivel institucioni paraqesin një analizë të ecurisë së programeve të studimit, të proceseve të vlerësimit, të problematikave të ndeshura dhe shoqërohen me rekomandime për trajtimin e tyre dhe përmirësim të mëtejshëm.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 36.5. Raporti vjetor i NJSBC 24-23.pdf; 36.6. Raporti vjetor i KC FBD 22-23.pdf; 41. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MP120.pdf; 70.1. Raporti vjetor I DBF 23-24.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i</p>	<p>Në takimet me drejtuesin e Fakultetit të Biznesit dhe të Drejtësisë dhe personelin akademik të këtij program studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në TBU përdoren procedura formale për mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza vjetore dhe semestrale si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ përditësimi dhe miratimi i syllabuseve të lëndëve çdo fillim viti akademik; ▪ në fund të çdo semestri, organizohet pyetëtori studentor për cilësinë e mësimdhënies; ▪ monitorime të procesit mësimor & analiza në mbledhjet e departamentit; ▪ diskutime të hapura me grupe të vogla studentësh (fokus grupe), etj; <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 36.5. Raporti vjetor i NJSBC 24-23.pdf; 36.6. Raporti vjetor i KC FBD 22-23.pdf; 36.9. Formatit i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët.pdf;</p>

shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	36.11. <i>Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu.pdf;</i> 36.10. <i>Raporti i Fokus Grupeve.pdf;</i> 70.1. <i>Raporti vjetor I DBF 23-24.pdf;</i> <i>vizita në institucion;</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	GVJ vlerëson angazhimin e TBU në krijimin e Bordeve të Tregut të Punës, në realizimin e takimeve me Bordin e Tregut të Punës së FBD, me studentët e diplomuar, të intervistave gjatë aktiviteteve si panairët e punës dhe të karrierës, si dhe në hartimin e raporteve gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe cilësinë e programeve të studimit që ofron. <i>Por, GVJ konstaton se këto raporte janë kryesisht përshkruese dhe nuk janë të dedikuar sipas programeve të studimit prandaj rekomandon një strukturim më formal të komunikimit me bashkëpunëtorët e jashtëm dhe studentët e diplomuar, opinioni i të cilëve do të ishte me vlerë për përditësimin e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës.</i> <i>Referenca:</i> 14.1.1. <i>TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës.pdf;</i> 14.1.2. <i>FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP.pdf;</i> 35. <i>Të dhëna për punësimin real të studentëve 20-23 (Aneks Tabela 23).pdf;</i> <i>vizita në institucion;</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se kuadri rregullator i TBU parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. <i>Gjithashtu, në raportet e analizës në nivel Departamenti, Fakulteti dhe TBU evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit si: Senati & Autoritetet drejtuese akademike, Komisioni i Përhershëm i Cilësisë (KC), Këshilli Studentor, si dhe Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC).</p> <p>Gjithashtu, Statuti i TBU parashikon edhe ngritjen e Komisionit të Përhershëm të Cilësisë në nivel institucioni dhe të Zyrës së Kurrikulave por nuk konstatoi ndonjë dokument lidhur me veprimtarinë apo kontributin e realizuar prej tyre në nivel TBU.</p> <p><i>Referenca:</i> 2. Statuti TBU.pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; 36.1. Rregullore NJSBC.pdf; 76. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.pdf; 78. Rregullore e Këshillit Studentor.pdf;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në rregulloren e NJBSC përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë si dhe standardet dhe politikat për procesin e vlerësimit të brendshëm. Gjithashtu, në dokumentin "Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies" paraqitet kuadri i sigurimit të cilësisë në TBU, roli i strukturave akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të brendshëm si dhe inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin e vlerësimit duke dhënë mendime përmes pyetësorëve të vlerësimit, fokus grupeve dhe angazhimit në strukturat qeverisëse të TBU.</p>
	<p><u>Megjithatë, siç u komentua edhe në Standardet VI.1 kriteri 2 dhe VI.4 kriteri 1, GVJ rekomandon përditësimin e kuadrit rregullator përsa i takon emërtimeve të disa të strukturave si dhe qartësimin e ndarjes së detyrave mes tyre, në funksion të</u></p>

	<p><u>sigurimit të cilësisë dhe në përputhje me ndryshimet e ndodhura dhe të publikuara në organigramën e TBU.</u></p> <p><i>Referenca:</i> 2. Statuti TBU.pdf; 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi i Avancuar" me 120 Kredite.pdf; 36.1. Rregullore NJSBC.pdf; 76. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.pdf;</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se TBU garanton që procesi i vlerësimin të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit të studimit të jetë gjithëpërfshirës, duke përfshirë jo vetëm studentët dhe personelin akademik në dhënien e opinioneve të tyre për programin e studimit, por duke i përfshirë edhe në përbërjen e strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Në TBU është ngritur dhe funksionon Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë me katër anëtarë: tre anëtarë nga personeli akademik dhe një student. Gjithashtu, disa studentë dhe pedagogë janë përfshirë në aktivitetet e NJBSC si anëtarë të GVB-ve të programeve të studimit në proces akreditimi.</p> <p><i>Referenca:</i> 36.1. Rregullore NJSBC.pdf; 36.2.. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25.pdf; 72. Përfshirja e studenteve në qeversijen e TBU.pdf; 73. Urdhër Rektori – Ngritja e GVB për akreditimin e programet e studimit.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimin duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ vlerëson se TBU garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimin dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve.</p> <p><i>Referenca:</i> 18. Kodi i Etikës.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimin dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë</p>	<p>Gjithashtu, GVJ konstaton se TBU angazhohet në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimin dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Aktivitete si takimet me Bordin e Tregut të Punës, leksione të hapura me personalitete të fushës,</p>

dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit, angazhimi në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare janë mekanizma përmes të cilave TBU realizon diskutimin dhe ndarjen e mendimeve lidhur me cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit në funksion të nevojave të tregut dhe zhvillimeve bashkëkohore.</p> <p><i>Referenca:</i> 14.1.2. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP.pdf; 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët.pdf; 34. Projektet e fituara nga TBU-34.1.Projekte ku është përfshirë DBF.pdf; 37.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MPABA120).pdf; 37.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf; vizita në institucion;</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se <u>kuadri rregullator i TBU përcakton strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimin të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit, por ka nevojë të përditësohet përsa i takon emërtimeve të disa të strukturave si dhe qartësimin e ndarjes së detyrave mes tyre.</u></i></p> <p><i>Gjithashtu, TBU siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, GVJ vlerëson se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen e tij zyrtare në internet të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni.</p> <p>Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në</p>

<p>publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes publikimeve në faqen zyrtare në internet të TBU, komunikimeve në platformën LMS TBU dhe nga personeli akademik. GVJ konstatoi se gjatë kohës së përgatitjes së këtij raporti vlerësimi një pjesë e hapësirave për publikim në faqen zyrtare në internet e TBU nuk funksiononin. Në takimet e zhvilluara në TBU, GVJ u informua se faqja zyrtare në internet e TBU ishte në proces përditësimi si pjesë e procesit të riorganizimit të institucionit, rezultat i ndryshimeve strategjike në strukturën e pronësisë.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; https://tbu.edu.al/raporte-dhe-akreditime/; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ vlerëson se publikimet në faqen zyrtare në internet të TBU dhe raportet e analizave të publikuara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; https://tbu.edu.al/raporte-dhe-akreditime/; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se raporti vjetor i analizës të zhvilluar në nivel departamenti shoqërohet me një plan vjetor aktiviteteve për t'u realizuar nga departamenti në vitin akademik pasues në funksion të realizimit të objektivave strategjike dhe të misionit të TBU.</p> <p>Gjithashtu, raportet vjetore të NJBSC dhe KC, në nivel institucioni paraqesin një analizë të ecurisë së programeve të studimit, të proceseve të vlerësimit (pyetësorëve, diskutimeve me fokus grupet), të problematikave të ndeshura dhe shoqërohen me rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe të problematikave të evidentuara.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 36.5. Raporti vjetor i NJSBC 24-23.pdf; 36.6. Raporti vjetor i KC FBD 22-23.pdf; 41. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MP120.pdf;</p>

	<p>70. Plani vjetor i DBF 23-24.pdf; 70.1. Raporti vjetor I DBF 23-24.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i raporteve vjetore të analizës së veprimtarisë në nivel departamenti dhe TBU, GVJ konstatoi se raportet përfshijnë edhe tregues të matshëm për vlerësimin e efektivitetit të aktiviteteve të ndërmarra. Në mbledhjet e departamentit të Biznesit dhe Financës, personeli akademik analizon ecurinë dhe problematikat e procesit mësimor, punën kërkimore shkencore, angazhimin administrativ, aktivitetet me studentët si dhe përcaktohen objektivat për vitin e ardhshëm akademik në funksion të përmirësimit të vijueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Referenca:</i> 41. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MP120.pdf; 43.1.1. Indikatorët e vlerësimit të performancës kërkimore-shkencore për personelin akademik.pdf; 70. Plani vjetor i DBF 23-24.pdf; 70.1. Raporti vjetor i DBF 23-24.pdf; 71.3. Raporti vjetor institucional 2023-2024.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në takimet me drejtuesin e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë dhe personelin akademik të këtij program studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin dhe përkushtimin e personelit akademik për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë së programit të studimit përmes analizave dhe veprimtarive periodike me pedagogët dhe studentët në funksion të këtij kriteri, përditësimeve të materialeve mësimore, publikimeve në faqen zyrtare në internet të TBU me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>Referenca:</i> 01. TBU - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Master Profesional 120 ECTS (Periodik).pdf; 41. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MP120.pdf; 70. Plani vjetor i DBF 23-24.pdf; 70.1. Raporti vjetor I DBF 23-24.pdf; vizita në institucion;</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i TBU parashikon publikimin në faqen e tij zyrtare në internet të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni.</p>

	<p><i>Megjithëse jo plotësisht funksionale, publikimet në faqen zyrtare në internet të TBU dhe raportet e analizave të publikuara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i></p> <p><i>Gjithashtu, TBU angazhohet për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të personelit dhe studentëve, në sigurimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Administrim Biznes i Avancuar” me profile: Menaxhim; Kontabilitet – Financë; E drejtë biznesi;

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Përkatësia me Grupin Balfin është një garanci për mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm;
2. Stafit drejtues i Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë i angazhuar dy vitet e fundit, për shkak të eksperiencës në sektor ka bërë ndryshime dhe përmirësime të qenësishme në funksionimin e Fakultetit, dhe përputhjen e programeve me standardet dhe udhëzimet;
3. Infrastruktura fizike e përshtatshme për një proces mësimor efektiv, krahasuar edhe me numrin aktual të studentëve;

b. Pika të dobta:

1. Inercia e trashëguar në përmbajtjen e programit të studimit MPAAD me 120 ECTS dhe mungesa e një studimi tregu specifik për këtë program studimi; *(Standardi I.1 kriteri 3);*
2. Angazhimi i stafit akademik me kualifikime Msc në këtë program studimi dhe qëndrueshmëria relative në vite e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit; *(Standardi III.1, kriteri 4; Standardi IV.1, kriteri 1)*
3. Kuadri rregullator i institucionit duhet të përditësohet:
 - a. në përputhje me ndryshimet e miratuara në planet mësimore të këtij programi studimi;
 - b. me kërkesa më specifike lidhur me organizimin dhe vlerësimin e detyrimeve përmbyllëse të parashikuara në planin mësimor të këtij programi studimi; dhe
 - c. të plotësohet me emërtime strukturash dhe ndarje detyrash mes tyre, në përputhje dhe me ndryshimet e ndodhura në organizimin e TBU; *(Standardi III.3, kriteri 6; Standardi III.4, kriteri 1; Standardi III.5, kriteri 3);*
4. Numri i ulët i personelit administrativ dhe mungesa e personelit ndihmës-mësimor, pavarësisht numrit të ulët të studentëve, ndikon cilësinë e dokumentacionit dhe të shërbimeve të institucionit; *(Standardi IV.1, kriteri 5)*

Rekomandime



1. GVJ sugjeron që departamenti të vlerësojë ofertën e tij akademike nisur nga qasja aktuale e TBU, dhe ndryshimet dinamike në tregun e punës. Departamenti do të duhet të definojë profilin e studentëve që ndjekin MP ABA – 120 ECTS, profilin e studentit të Msc dhe të atij MP AB 60 ECTS, dhe mbi këtë bazë të marrë vendime për ofertën e tij akademike. Institucioni duhet të realizojë një studim tregu të dedikuar për këtë program studimi;
2. Institucioni duhet të rishikojë dhe përditësojë kuadrin rregullator, në përputhje dhe me ndryshimet e ndodhura në organizimin e TBU dhe duke harmonizuar kërkesat në to;
3. Institucioni duhet t'i kushtojë vëmendje angazhimit të një personeli akademik të qendrueshëm dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për programet master;
4. Institucioni duhet të rrisë numrin e personelit administrativ dhe të punësojë personel ndihmës – akademik për një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi, si dhe për të rritur cilësinë e shërbimit dhe të dokumentacionit të institucionit;
5. Institucioni duhet të përcaktojë disa indikatorë që do të vlerësonin performancën e marrëveshjeve të bashkëpunimit, si dhe duhet të marrë në konsideratë nënshkrimin e marrëveshjeve specifike vetëm për praktikën mësimore për këtë program studimi;
6. TBU duhet të rrisë përpjeket për ndërkombëtarizimin, duke nisur me krijimin e njësisë që fokusohet në marrëdhënië ndërkombëtare dhe projekte ndërkombëtare dhe vijuar me më shumë MoU për mobilitete të stafit akademik, administrativ dhe studentëve; projekte Erasmus, etj;
7. Rishikimi i përmbajtjes së programit pas akreditimit, GVJ sugjeron të ketë prezencë të ëndëve si Sipërmarrje, Inovacioni, Kapitali Human, Digjitalizim & AI, Metoda Kërkimi;
8. Përmirësimi i Përgatitjes për Tregun Ndërkombëtar, Zhvillimi i lëndëve në gjuhën angleze për të rritur aftësitë ndërkombëtare të studentëve dhe lehtësuar integrimin e tyre në tregun e huaj të punës si dhe hartimi i programeve të përbashkta me universitetet perëndimore;
9. Hartimin e një politike me kritere të qarta dhe të matshme për mbështetjen e aktivitetit kërkimor shkencor të stafit akademik;



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in Advanced Business Administration with 120 ECTS

a. Strengths and affirmations:

1. Affiliation with the Balfin Group is a guarantee of the possibility of further development and progress;
2. The management staff of the Faculty of Economics and Law engaged in the last two years, thanks to the experience gained in the sector, has made substantial changes and improvements to the functioning of the faculty and to the compliance of the study programs with the regulatory framework;
3. The adequate infrastructure and facilities for effective teaching and learning, given the current number of students;

b. Weaknesses:

1. Past inertia in the content of the MPAD study program with 60 ECTS and lack of a specific market study for this study program; *(Standard I.1, criterion 3)*
2. Engagement of academic staff with Msc qualifications in this study program and the relative stability over the years of academic staff; *(Standard III.1 criterion 4; Standard IV.1 criterion 1)*
3. The institution's regulatory framework must be updated:
 - a. in accordance with the changes approved in the teaching plans of this study program;
 - b. with more specific requirements related to the organization and the evaluation of the final obligations foreseen by the curriculum of this study program; and
 - c. to be completed with names of structures and division of tasks between them, in accordance with the changes that occurred at the organizational level of TBU. *(Standard III.3 criterion 5; Standard III.4 criterion; Standard III.5 criterion 5)*
4. The low number of administrative staff and the lack of support-teaching staff, despite the low number of students, affects the quality of documentation and services at the institution; *(Standard IV.1 criterion 5)*



Recommendation

1. It is recommended that the department assess its academic offerings based on TBU's current approach and the dynamic changes in the labor market. The department should consider defining the profile of students enrolled in MP ABA – 120 ECTS, MSc students, and MP AB – 60 ECTS students, and use this information to inform decisions regarding its academic program. Additionally, the institution might find it beneficial to conduct a dedicated market study for this study program;
2. It is advisable for the institution to review and update the regulatory framework to align with recent organizational changes within TBU and to harmonize the existing requirements;
3. It is suggested that the institution focus on ensuring the engagement of a stable academic staff that complies with the current regulatory standards for master's programs;
4. The institution may consider increasing the number of administrative personnel and hiring support staff—both academic and non-academic—to clearly delineate duties and responsibilities, thereby enhancing service quality and institutional documentation;
5. It is recommended that the institution establish specific indicators to evaluate the performance of cooperation agreements. Furthermore, it could consider signing targeted agreements specifically related to internship placements for this study program;
6. TBU is encouraged to intensify its efforts toward internationalization, starting with the creation of a dedicated unit focused on international relations and projects, and expanding the number of MoUs for staff, administrative, and student mobility, including Erasmus projects;
7. Following accreditation, a review of the program content is advisable. It is suggested that topics such as Entrepreneurship, Innovation, Human Capital, Digitalization & AI, and Research Methods be incorporated into the curriculum;
8. To enhance preparation for the international market, it is recommended to develop courses in English that strengthen students' international skills and facilitate their integration into foreign labor markets. Additionally, joint programs with European universities could be developed;
9. It is recommended to formulate a clear and measurable policy to support the research activities of academic staff;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X